



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS MUZIKË NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Material në ndihmë të mësuesit

2023

Koordinoi hartimin e udhëzuesit

Marina Topulli, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Gerti Janaqi

Dr. Dorina Rapti

Koordinoi redaktimi letrar

Miranda Kurti

Koordinoi faqosjen

Eriksen Mersinllari

Prodhim i ASCAP, 2023

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës “ Muzikë ” në arsimin e mesëm të lartë është produkt i konsultimeve dhe i diskutimeve me mësues dhe me specialistë të kësaj lënde në këtë cikël shkollimi.

TABELA E PËRMBATJES

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS SË MUZIKËS	5
1.1 Qëllimi i udhëzuesit	5
1.2 Përdoruesit e udhëzuesit.....	5
1.3 Struktura e udhëzuesit	5
II. RËNDËSIA LËNDËS SË MUZIKËS.....	6
2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënës në lëndën e muzikës	7
2.2 Rëndësia e lëndës së muzikës.....	8
2.3 Shtrirja e lëndës së muzikës	10
III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE MUZIKORE.....	11
IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR.....	14
V. TEMAT NDËRKURRIKULARE	16
VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES - NXËNIES NË MUZIKË	17
6.1 Stilet e të nxënës	19
6.1.1 Stili i të nxënës pamor:	19
6.1.2 Stili i të nxënës dëgjimor:.....	19
6.1.3. Stili i të nxënës kinestetik:.....	20
6.2. Teknika të mësimdhënies.....	21
6.2.1 Kllasteri	21
6.2.2. Rrjeti i diskutimit	22
6.2.3. Brainstorming:	22
6.2.4. Kubimi:	23
6.2.5. Tabela e koncepteve:.....	24
6.2.6. Diagrama e Venit	24

6.2.7. Harta e të pyeturit	25
6.2.8. Teknika “Përdorimi i teknologjisë / interneti	26
6.2.9. Teknika “Di – Dua të di – Mësova”.....	26
6.2.10 Teknika “Hulumtimi”	27
VII.PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR.....	30
7.1. Llojet e planifikimeve	31
7.2. Planifikimi vjetor i lëndës	31
7.3 Planifikimi sipas periudhave	34
7.4 Planifikimi ditor.....	50
VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN MUZIKË	63
8.1 Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë).....	64
8.2 Vlerësimi i të nxënit (Detyra përmbledhëse)	64
8.3 Projekti.....	69
8.4 Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi	77
8.5 Vlerësimi i të nxënit të nxënësit	78
8.5.1 Vlerësimi periodik	78
8.5.2 Vlerësimi përfundimtar	78
8.6. Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta	79
IX. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRA TË NDRYSHME NË LËNDËN E MUZIKËS, AML	80
9.1. Kriteret për kryerjen e detyrave	80
9.2. Reflektimi i mësuesit	81

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS SË MUZIKËS

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi lëndor i lëndës së muzikës për arsimin e mesëm të lartë, trajton në mënyrë më të thellë të gjitha aspektet e kurrikulës që nga planifikimi i saj, metoda të mësimdhënies, metoda të të nxënimit të nxënësve, vlerësimin e të nxënimit në kontekstin e zhvillimit të kompetencave gjatë zbatimit të programit të muzikës, e cila zhvillohet si lëndë me zgjedhje në AML klasat 10 - 12. Në këtë udhëzues janë kombinuar të gjitha materialet në zbatim të kurrikulës me kompetenca, me eksperiencën dhe praktikën më të mira të mësuesve në shkollë.

1.2 Përdoruesit e udhëzuesit

Udhëzuesi u vjen në ndihmë punonjësve arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe si i tillë përdoret:

- nga mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit të cilët punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë e të nxënimit dhe rezultateve të nxënësve në lëndën e muzikës;
- nga të gjitha institucionet arsimore në varësi të MAS-ë, njësitë arsimore vendore për zhvillimin profesional, këshillimin, vëzhgimin, monitorimin, kualifikimin e punonjësve arsimorë;
- nga institucionet e arsimit të lartë që përgatisin mësues në lëndën e muzikës, të cilët mund t'i referohen për formimin fillestar të mësuesve të rinj.

1.3 Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi kërkon të japë përgjigje për një sërë pyetjesh dhe çështjesh të ngritura nga drejtuesit e shkollës, mësuesit, nxënësit, prindërit të cilët herë pas here kanë dilemat e tyre në lidhje me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në lëndën e muzikës.

Në këtë panoramë sfidash, një vend të veçantë merr progresi i nxënësit në zotërimin e muzikës. Ajo që kuptojmë me progresin, a pajtohet me atë që ne kuptojmë me konceptin e zotërimit të muzikës? Kjo është e lidhur ngushtë me një tjetër sfidë, disi më e gjerë, problemi i vlerësimit. Problemi i vlerësimit përbëhet nga dy çështje:

- së pari, është çështja e interpretimit në mënyrë të vlefshme dhe të besueshme e vlerësimit, të cilën ne e perceptojmë si një nga komponentët kyç të zotërimit të muzikës. Kjo lidhet me hartimin dhe miratimin e instrumenteve të vlerësimit që matin njohuritë dhe aftësitë e

nxënësve në muzikë. Përdorimi i këtyre instrumenteve nuk duhet të çojë në rezultate të gabuara kur ne nxjerrim konkluzione rreth zotërimit të kompetencës muzikore të nxënësve. Problemi më i madh këtu është se instrumentet mund të manipulohen duke prodhuar rezultate të pavërteta, kryesisht për shkak të vlefshmërisë së pamjaftueshme që sakrifikohet shpesh për të mirën e besueshmërisë;

- së dyti, është çështja e mospërputhjeve të shpeshta ndërmjet tre komponentëve: I) mënyrave të vlerësimit; II) qëllimeve të lëndës; III) formave të mësimdhënie - nxënies në muzikë.

Sigurisht ka edhe shumë sfida dhe probleme të tjera, por ristrukturimi i sistemit të formimit muzikor bazuar në parimet bazë të të mësuarit e muzikës, ndërmjet të cilave është: “Të gjithë nxënësit janë të aftë të nxënë muzikën dhe ta interpretojnë atë”.

II. RËNDËSIA LËNDËS SË MUZIKËS

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit. Kjo tregon që muzika krijon edhe historinë e vet përmes kultivimit e sofistikimit të “këngës” primitive dhe kultivimin e përpunuar të zërit njerëzor e të instrumenteve të muzikës. Të bashkërenduara e të nënrenduara në procesin e edukimit, ato do të kërkojnë të trajtohen në mënyrë të veçantë e sistematike edhe në këtë program lëndor.

Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësin të kuptojë dhe lidhë fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset, teknikat dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre, si dhe duke shpjeguar mënyrat e interpretimit dhe ndërtimit, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimi të muzikës.

Vazhdimi i rrugëtimit të njohjes me muzikën është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të dëgjuar në mënyrë të pavarur e sistematike vepra të ndryshme muzikore si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë kritike rreth tyre.

Muzika është e pranishme kudo në jetën tonë të përditshme (në klasë, shtëpi, TV, film, koncert, teatër, kolonë zanore, ngjarje të shënuara familjare, veprimtari brenda dhe jashtë shkollës, ngjarje të komunitetit etj.).

Muzika nuk mund të kuptohet dhe realizohet duke marrë vetëm disa njohuri, por duke vazhduar njohjen më të plotë të saj përmes gjuhës muzikore dhe komunikimit nëpërmjet saj, të njohjes me

veprat muzikore, teknikat dhe proceset nëpër të cilat zhvillohet muzika, realizuar kjo nëpërmjet dëgjimit të veprave muzikore dhe kuptimit të tyre sipas formës, gjinisë dhe stilit, njohjes me zhvillimin kulturor dhe historik të muzikës, njohuri që bëjnë të vetëdijshëm nxënësin për rolin e muzikës në jetën e përditshme dhe vlerësimin e saj nëpërmjet një gjuhe të saktë muzikore.

2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e muzikës

Muzika përdoret në një numër të madh të aktiviteteve të përditshme ku megjithëse zbatimet e saj janë nga më të ndryshmet, ato nuk mund të kuptohen pa marrjen e disa njohurive themelore të elementeve dhe parimeve kryesore e cila ka të bëjë me gjuhën me të cilën komunikon muzika. Gjuha muzikore e bën të vetëdijshëm nxënësin për rolin e muzikës në jetën e përditshme, duke zgjeruar botëkuptimin e tij.

Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit të lëndës së muzikës është të inkurajojë dhe t'i mundësojë nxënësit:

- të përjetojë dhe vlerësojë vlerat e muzikës kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar për ta ruajtur dhe për ta kultivuar identitetin kombëtar;
- të zhvillojë aftësitë e përjetimit estetik dhe vlerësimit kritik.
- të përjetojë dhe vlerësojë muzikën e epokave të ndryshme sipas stilit, gjinive dhe llojeve muzikore, duke zhvilluar aftësitë e përfytyrimeve dhe përjetimeve muzikore mbi veprat që dëgjon;
- të zhvillojë aftësitë e bashkëpunimit dhe të krijimit të raporteve ndërmjet kulturave duke ndër vepruar në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupe të ndryshme kulturore apo etnike;
- të kuptojë forma të ndryshme të veprimtarisë muzikore duke zhvilluar aftësitë krijuese, individuale;
- të zhvillojë kompetencat muzikore për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme muzikore, punë të pavarur, duke krijuar përmbledhje nga vepra të ndryshme muzikore shqiptare apo të botërore;
- të marrë pjesë në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë në shërbim të mjedisit, ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet;
- të japë kontributin personal në zhvillimet artistike muzikore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

- të ndër veprojë në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- të japë kontributin personal në zhvillimet artistike muzikore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

2.2 Risitë e lëndës së muzikës

Trajtimi i lëndës së muzikës ***nëpërmjet kompetencave është risia kryesore e lëndës së muzikës.*** Zotërimi i njohurive muzikore nënkupton zotërimin e kompetencave muzikore. Por, çdo të thotë kjo?

Zotërimi i një kompetence (pra të jesh kompetent) në një fushë personale, profesionale apo shoqërore do të thotë të zotërosh në një shkallë të caktuar, modelime të rrethanave në aspekte të ndryshme të jetës në atë fushë. Në këto kushte, zotërimi i kompetencave muzikore do të thotë aftësia për të kuptuar, gjykuar përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh jashtë muzikore, si dhe situatave në të cilën muzika luan ose mund të luaj një rol të rëndësishëm.

Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimi të muzikës me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencat muzikore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe, p. sh.: kompetenca e muzikës “interpretimi/performimi muzikor” përfshin shumë nga teknikat e ndryshme të të kënduarit, të të bërit muzikë apo luajtjes në instrumente muzikore. Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së muzikës mësuesi ndjek hapat e mëposhtme:

- *përzgjedh rezultatin/et e të nxënit nga kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse dhe i zbërthen ato;*
- *përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së muzikës që synon të arrijë nxënësi;*
- *zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së muzikës për vit mësimor,*

rezultatit/et e të nxënit për shkallë;

- *përzgjedh* përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizohen rezultatet e të nxënit të kompetencave muzikore në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- *planifikon mësimdhënien* duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- *kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve* pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e muzikës. Kurrikula e muzikës është strukturuar me tre kompetenca, të cilat përmenden si më poshtë:

Tabela 1: Kompetencat muzikore

Kompetenca	Treguesit
Kompetenca: Krijimi muzikor Kjo kompetencë ka të bëjë me kuptimin dhe përdorimin e njohurive muzikore duke zhvilluar aftësitë krijuese individuale por edhe në grup.	Disa tregues kryesorë janë: ▪ përdor ide të ndryshme për të organizuar mendimin e tij personal estetik- muzikor; ▪ zhvillon mendimin e tij mbi elementet muzikore gjatë analizimit të veprës muzikore; ▪ shpreh përjetimet dhe përfytyrimet muzikore gjatë dëgjimit muzikor të një veprë muzikore; ▪ organizon njohuritë e veta për të shprehur mesazhin e veprës muzikore; ▪ ndan përvojat e veta muzikore me të tjerët.
Kompetenca: Performimi/interpretimi muzikor Kjo kompetencë ka të bëjë me zhvillimin e aftësive interpretuese/performuese, duke u bazuar në ritëm, intonacion, interpretim, stilistikë, si aspekte themelore të performancës muzikore në këndim apo instrument muzikës.	Disa tregues kryesorë janë: ▪ performon dhe interpreton emocionalisht gjatë procesit të këndimit këngë korale dhe të rrymave të ndryshme moderne, kanone, këngë popullore, etj., duke zhvilluar një kuptim të qartë të këndimit vetëm dhe në grup; ▪ përjeton emocionalisht gjatë procesit të dëgjimit, vepra të ndryshme muzikore (vokale apo instrumentale), duke zhvilluar një kuptim të qartë të veprës muzikore;

	▪ këndon motive apo tema mjaft të njohura të pjesëve muzikore apo melodive të përzgjedhura (rinjohje nëpërmjet fishkëllimit apo këndimit të temave kryesore); ▪ jep gjykimin dhe mendimin e vet mbi përmbajtjet muzikore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të tyre(ese-ja); ▪ ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.
Kompetenca: Vlerësimi i veprave muzikore Kjo kompetencë ka të bëjë me kuptimin, gjykimin dhe vlerësimin e veprave muzikore duke i njohur ato në hapësirë dhe në kohë përmes historisë dhe kompozitorit të veprës, bazuar në kontekstin historik, artistik, politik në të cilën është krijuar vepra.	Disa tregues kryesorë janë: ▪ zhvillon gjykimin e vet muzikor dhe estetik mbi veprat të ndryshme muzikore; ▪ analizon veprat muzikore (vokale dhe instrumentale), duke u mbështetur veçorinë e ▪ veprave muzikore; ▪ bën krahasimin midis dy veprave muzikore, duke u shprehur me një gjuhë të qartë ▪ muzikore dhe përdorur terminologji të qartë muzikore; ▪ vlerëson veprat muzikore, sipas llojit muzikor, autorit, vendit dhe periudhës ▪ historike në të cilën është realizuar vepra, duke ndërtuar një gjykim kritik dhe estetik.

Organizimi i mësimit të muzikës me bazë kompetencat, siguron zhvendosjen e fokusit të nxënies nga përmbajtja lëndore (mësuesi në qendër) në atë që nxënësit kanë nevojë të dinë dhe të bëjnë me efikasitet në situata të ndryshme të nxëni (nxënësi në qendër). Nxënësit mësojnë nga njerëzit dhe materialet përreth tyre.

2.3 Shtrirja e lëndës së muzikës

Sipas Kornizës së Kurrikulës së Shqipërisë dhe planit mësimor ndarja e kohës mësimore për arsimin e mesëm të lartë (AML), fusha e arteve zhvillohet me 6 orë mësimore/javore. Në shkallën

e pestë dhe të gjashtë të kurrikulës, artet zhvillohen, në kurrikulën me zgjedhje klasat 10,11,12 të, artet zhvillohet në 2 orë:

- Muzikë 2 orë
- Art pamor 2 orë
- Teatër 2 orë

Lënda e muzikës zhvillohet për 36 javë mësimore me nga 2 orë mësimore secila (45 minuta), pra gjithsej 72 orë. Lënda e muzikës zhvillohet përmes tre tematikave përmbajtësore: *Gjuha dhe komunikimi muzikor (GJKM)*, *Teknika dhe procese (TP)* dhe *Historia, muzika dhe shoqëria (HMSH)*.

Megjithëse njohuritë përcaktohen për secilën tematikë, ato mund të trajtohen të integruara me njëra-tjetrën. Brenda shumës së orëve të lëndës muzikë, mësuesi planifikon të gjitha veprimtaritë që do të organizojë për një mësimdhënie – nxënie sa më efektive (si përmbajtja muzikore sipas programit, projekti, apo edhe veprimtari të tjera në ndihmë të përparimit të nxënësit).

Tabela 2: Tabela përmbledhëse e peshave për secilën tematikë.

KLASA	TEMATIKAT			GJITHSEJ ORË
	GJUHA DHE KOMUNIKIMI	TEKNIKA DHE PROCESE	HISTORIA MUZIKA DHE SHOQËRIA	
Klasa 10,11 ose 12-të	15	30	27	72 orë

III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE MUZIKORE

Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit. Kompetencat kyç janë ato që i nevojiten një individ për zhvillimin e tij personal, për punësimin, për përfshirjen në jetën sociale si qytetar aktiv, për përshtatjen në botën digjitale.

Zhvillimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies – nxënies nuk është një proces i veçantë, por mësuesi mban parasysh lidhjen e kompetencave kyç, me kompetencat muzikore. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat e të nxënësit, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme për procesin e të nxënësit. Kur nxënësi realizon

kompetencat muzikore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç.

Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet zhvillimit të kompetencave muzikore dhe përmbajtjes së lëndës nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

- 1) **Kompetencat kyç “Komunikimi dhe të shprehurit” dhe “Të menduarit”** të cilat zhvillojnë te nxënësit të kuptuarin e mesazheve që u drejtohen, shprehen në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, përpunojnë në mënyrë të pavarur, kritike, ndërvepruese dhe krijuese informacionin, mund të lidhet mjaft mirë me kompetencën muzikore “Të menduarit dhe komunikimi muzikor”. Disa ilustrime konkrete të pyetjeve tipike dhe përgjigjeve për të zhvilluar këto kompetenca, në nivele të ndryshme arsimore, mund të jenë:

Shembulli: Ndërtimi i intervaleve

I: Bora ka përzgjedhur për temën “Muzika moderne” këngëtarin e saj të preferuar Dua Lipa. Ajo flet rreth kësaj këngëtareje duke listuar argumentet e saj pse i pëlqen kjo këngëtare më shumë se Rita Ora. A e bëri drejtë Bora gjykimin mbi këto dy këngëtare? Nëse jo? Si duhej bërë?

II: Po Bora ka të drejtë të krahasojë këto dy këngëtare nëse në listimin e argumenteve të saj ndalet në:

- Rrymën muzikore që ato këndojnë.
- Interpretimin që i dallon ato nga njëra – tjetra.
- Çmimet që ato kanë marrë.
- Turnetë që ato kanë bërë.
- Ndjekësit që ato kanë.

Nëse ky listim bazohet në argumente të qëndrueshme gjykimin ia ka arritur qëllimit.

- 2) **Kompetenca kyç “Të mësuarit për të nxënë”** e cila i krijon nxënësve mundësitë për të përdorur strategji të ndryshme të nxëni dhe e përgatitet për të nxënit gjatë gjithë jetës mund të lidhet më së miri me kompetencën muzikore “Zgjidhja e situatës problemore”. Një ilustrim konkret i një situatë të nxëni për të zhvilluar këtë kompetencë, mund të jetë:

Shembull

“Në një nga esetë që duhet të krijojnë nxënësit lidhur me një dëgjim muzikor, të kompozitorëve romantikë” duhet të zhvillojnë aftësitë e të menduarit personal dhe kritik.

Për të realizuar këtë ju duhet të përcaktoni kriteret e esesë?

Çfarë veprë do të zgjidhni vokale apo instrumentale për të shprehur përjetimet personale? Pse e keni zgjedhur këtë kompozitor? Shpjegoni pse kjo vepër muzikore dhe ky kompozitor është përfaqësues i këtij lloji zhanri apo gjinie?

A ka mënyrë tjetër për të zhvilluar aftësitë e të menduarit personal dhe kritik në një formë tjetër?”

- 3) **Kompetencat kyç “Personale” dhe “Qytetare”** të cilat zhvillojnë te nxënësi vetëbesimin, vetëvlerësimin, besimin te të tjerët, bashkëjetesën sociale si qytetarë të përgjegjshëm, mund të lidhet shumë mirë me kompetencën “Vlerësimi”. Një ilustrim konkret i një aktiviteti që ndihmon në arsyetimin dhe propozimin e zgjidhjeve. Më pas nxënësit vetë mund bëjnë deduksionin e veprimeve të tyre.

Shembull

Nxënësit ndahen në dy grupe dhe diskutojnë këtë situatë:

“Kënga “Moj e bukura More” dhe “Lule Bore”.

- a) Jepni tri arsye se përse duhet të ruajmë vlerat e muzikës qytetare ?*
- b) Propozoni një zgjidhje tuajën lidhur me një nga mënyrat e ruajtjes së këngës së kultivuar, duke iu larguar muzikës së tallavasë. Arsyetoni pse jepni këtë propozim.*
- c) Shpjegoni pse kjo është një zgjidhje e mirë”.*

Si mund ta përmbledhni mendimin tuaj? Nëse përgjigjja e grupit tjetër është kundërshtuese, atëherë cila është përgjigjja juaj? Si mund të vlerësoni përgjigjen e grupit tjetër”.

- 4) **Kompetenca kyç “Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin”** e cila zhvillon te nxënësi shpirtin sipërmarrës, ndërmarrjen e iniciativave mund të lidhet me kompetencën “Ruajtja e mjedisit nga ndotja dhe zhurmat”. Një ilustrim konkret për të zhvilluar këtë kompetencë, në të cilën mund të modelohet një formulë funksioni mund të jetë:

Shembull “Si ta përmirësojmë mjedisin ku jetojmë”

Nxënësit nxiten:

- të shohin me sy kritik lagjen e tyre për të identifikuar zhurmat në mjedisin ku ata jetojnë, luajnë e pushojnë etj.*
- të reflektojnë dhe shprehen nëpërmjet informacioneve që kanë për muzikën, por edhe për mjedisin për të dhënë idetë e tyre mbi përmirësimin e këtij mjedisi*

- të mendojnë, arsyetojnë duke gjetur rrugë dhe mundësi për ndërgjegjësimin e ruajtjes së mjedisit nga zhurmat dhe ndotja e muzikës.

5) **Kompetenca kyç “Digjitale”** e cila zhvillon te nxënësi përdorimin efektiv të pajisjeve digjitale për të shkëmbyer, prodhuar, krijuar, prezantuar apo përpunuar informacionin mund të lidhet me kompetencën muzikore “Përdorimi i teknologjisë në muzikë”.

Një ilustrim konkret është realizimi i një studimi mbi një temë të caktuar lidhur me muzikën.

Shembull

- *“Formuloni një pyetësor për të mbledhur të dhëna rreth mendimeve të të rinjve kë zhanër muzikor pëlqejnë më shumë? Pse? Pyetini ata a shpenzojnë për të krijuar koleksion me muzikën e tyre të parapëlqyer?”*
- *Organizoni të dhënat që ju keni mbledhur dhe bëni të paktën një grafik që tregon se çfarë mendojnë të rinjtë rreth kësaj çështjeje.*
- *Përpiquni të gjeni informacione rreth studimeve të viteve të fundit për zhanret e pëlqyera nga të rinjve. Organizoni të dhënat dhe përdorni grafikët për të treguar informacionin.*
- *A përputhen mendimet e të rinjve që keni mbledhur me anë të pyetësorit me të dhënat që ju keni gjetur për vitet e fundit në lidhje me 2-3 zhanre? Shpjegoni.*
- *A mendoni ju se të dhënat dhe grafikët do të jenë të ndryshëm nëse ju përshkruani parapëlqimet e zhanreve të të rinjve sot me ata të 10 viteve më parë ? Ku bazoheni ?*

IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Muzika lidhet me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me lëndë të fushave të tjera në kurrikul. Shumë njohuri muzikore apo koncepte si *melodia, ritmi, harmonia, dinamika, tempi, format muzikore, struktura, kompozitorë, zhanre apo stile muzikore* etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike brenda fushës së arteve si: kërcimin, artin pamor, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore dhe mjedisi etj. Kështu mësuesit duhet t’u japin mundësinë nxënësve të rikujtojnë duke konsoliduar më mirë përvojat që ata kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Diagrami i mëposhtëm paraqit disa lidhje të muzikës me lëndë të tjera, përmes njohurive muzikore

Shembujt e mëposhtëm të integrimit ndërlëndor nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

Shembujt e mëposhtëm paraqitin disa lidhje të muzikës me lëndë të tjera, përmes njohurive.


MUZIKA	Gjuha dhe komunikimi - Gjetja e të dhënave muzikore mbi periudha, vepra dhe autorë. - Përshtatja e njohurive muzikore në nivele më të thjeshta. - Mbrojtja e një argumenti duke u bazuar në njohuritë muzikore. - Shkrimi i një opinionimi apo mendimi estetik/muzikor, përmes esesë ndaj një vepre muzikore.	Tema: “Oda e gëzimit” – Himni evropian Lidhet me gjuhën nëpërmjet rezultatit: Shkrimi i një opinionimi apo mendimi estetik/muzikor, përmes esesë ndaj një vepre muzikore.
	Shkencat shoqërore dhe mjedisi - Kultura. - Estetika - Identiteti kombëtar. - Trashëgimia kulturore.	Tema: Muzika moderne Lidhet me Qytetari nëpërmjet rezultatit: - Kultura.
	Shkencat e natyrës - Harmonia. - Dinamika. - Valët	Tema: Elementet e muzikës Lidhet me Fizikën nëpërmjet rezultatit: - Valët.
	TIK - Mbledhja e informacionit mbi jetën e kompozitorëve nëpërmjet internetit. - Organizimi dhe përpunimi i informacionit të gjetur. - Analiza dhe interpretimi i informacionit. - Paraqitja dhe prezantimi i materialit	Tema: Arti muzikor në klasicizëm Lidhet me TIK nëpërmjet rezultatit: - Mbledhja e informacionit mbi jetën e kompozitorëve nëpërmjet internetit.
	Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti - Vallëzimi ritmik.	Zhvillimi i ritmeve muzikore të mësuara


V. TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Muzika ka një shumëllojshmëri zbatimesh në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e dyfishtë sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare (*Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Zhvillimi i qëndrueshëm; Mjedis; Ndërvarësia; Bashkëjetesa paqësore*) nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdorë elemente të gjuhës muzikore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave muzikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave. Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në rritjen e tij personale duke e ndihmuar atë të gjejë vendin e tij në shoqëri. Nxënësi mund të përdorë metodat statistikore (anketa, intervista) për të bërë analiza rreth mendimit të njerëzve, mund të arsyetojë dhe të argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin. Nxënësi inkurajohet të veprojë aktivisht në mjedisin e tij duke ruajtur një qëndrim kritik ndaj zhurmave që krijohet nga muzika e lartë. Nxënësi përdor aftësitë e tij muzikore që kanë të bëjnë me simbole, forma, vepra muzikore për të vepruar në mënyrë aktive në mjedisin e tij.

Model me dy tema ndërkurrikulare

Modele të sjella si shembull tregojnë qartë lidhjen e njohurive të muzikës me temën: **Identiteti Kombëtar** dhe **Bashkëjetesa paqësore**.





VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES - NXËNIES NË MUZIKË

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: *individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete* etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat kyçe dhe kompetencat lëndore, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë muzikore. Të dy këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies, të cilat përshtaten me objektin e të nxënës dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie – nxënie e mirë menduar dhe e mirë planifikuar, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat muzikore janë të ndërlidhura, me sinergji dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënës që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari krijuese apo përforcuese, hulumtime mbi vepra dhe përfaqësues, krijime ose simulime të njohurive muzikore, aftësive, krahasime të veprave muzikore apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.

Çfarë dëgjoj, e harroj

Çfarë dëgjoj dhe shikoj, e kujtoj pak

Çfarë dëgjoj, shikoj dhe diskutoj, filloj ta kujtoj


Çfarë dëgjoj, shikoj, diskutoj dhe bëj, fitoj njohuri dhe aftësi

Çfarë i mësoj dikujt tjetër bëhem kompetent.

(Sillberman, 1996)

Në mbështetje të këtyre fjalëve të Sillberman paraqitet edhe në mënyrë skematike piramida e të nxënës nga Edgar Dale. Nxënësit janë të aftë të nxënë shumë mirë nëse:

Figura 1: Piramida e të nxënit



Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një moment/fazë e cila kërkon të japë njohuritë e duhura nxënësit, të nxisë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate pikërisht nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyrë të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënit*. Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit*, të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar*, disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit*, disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënit, janë mësimdhënësit të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënit këto metoda.

Mësues të caktuar përdorin më shumë demonstrimin, të tjerë ligjërimin, reflektimin, diskutimet, por ka të atillë që përqendrohen më shumë në të menduarit, te kujtesa, në të kuptuarit. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënit, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies dhe të të nxënit. Përmes stileve të të nxënit mësuesi:

- Ruan *përfshirjen aktive*;
- Nxiti *diskutim të hapur*;
- Nxiti nxënësit të krijojnë dhe të bëjnë pyetjet e tyre;
- Ndhmon *shprehjen e mendimeve* të nxënësve;
- Ruan *motivimin* e nxënësve për të mësuar;
- Siguron një mjedis ku *respektohen mendimet*;
- Krijon një shtresë për *reflektim* në atë që nxënësit *vlerësojnë*;
- Shërben si nxitje për *ndryshim*;
- Vendosi shpresë për *përfshirjen kritike* të nxënësve;
- Ndhmon *mendimin kritik* në nivele të larta e të ndërlikuara.

6.1 Stilet e të nxënësve

6.1.1 Stili i të nxënësve pamor:

Përmes zbatimit të këtij stili të të nxënësve nxënësi përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast mësimi konkretizohet, duke përdorur mjete mësimore si: *foto, harta, fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, makete, ilustrime, vizatime, dvd (ku kemi dy lloje stilesh pamore dhe dëgjimore)* etj.. Të nxënësve përmes shqisës së të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një personalitet, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore,
- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

6.1.2 Stili i të nxënësve dëgjimor:

Përmes zbatimit të këtij stili të të nxënësve nxënësi përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet *incizimeve, bisedave, diskutimeve* ku bëhen vlerësime, jepen mendime, përfundime, bëhen analiza etj. Të nxënësve përmes shqisës së dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës apo një situatë në kontekstin e temës mësimore,
- biseda dhe diskutime në grup për prezantimin e punëve të ndryshme,
- veprimtari që kërkon të folur të rrjedhshëm dhe të qartë.

6.1.3. Stili i të nxënit kinestetik:

Përmes zbatimit të këtij stili të të nxëni nxënësi përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke *vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar* etj.. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore,
- përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat,
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënit nxënësit zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme p.sh.: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore, apo aktivitete në grup, performime muzikore dhe kërcimore në shfaqjet skenike, kërcim apo teatër, vëzhgime dhe analiza të veprave figurative, biseda dhe debate në lidhje me çështje të caktuara shkencore etj..

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësues të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore, duke përdorur mjaft teknika dhe metoda të mësimdhënies.

Tematikat dhe përmbajtjet mësimore, janë të integruara në funksion të mësimi të muzikës. Realizimi i këtyre përmbajtjeve, përmes veprimtarive të ndryshme muzikore ndihmon në njohjen, edukimin dhe kultivimin e nxënësve me vlerat muzikore më të spikatura të kulturës kombëtare shqiptare por edhe ato botërore.

Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimi të muzikës ku ndihmojnë dhe stilet e të nxënit janë:

- 1) *Mësimi i këngëve* bën pjesë në stilin e të nxënit pamor, dëgjimor por edhe kinestetik, sepse këngët duhet:
 - të mësohen;
 - të këndohen duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe repertori i sugjeruar për t'u mësuar;
 - të shoqërohet edhe me instrumente muzikore popullore, por edhe ORF;
 - të shoqërohet me lëvizje trupore.
- 2) Në fushën e *lojës me instrumente muzikore* mësuesi bashkëpunon dhe angazhon nxënësit në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare të ngjashme edhe me instrumentet ORF për *shoqërimin e këngëve* që këndojnë.
- 3) *Dëgjimi muzikor* është veprimtari muzikore që bën pjesë në stilin e të nxënit dëgjimor, dhe kinestetik, sepse edukon përqendrimin dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës, por synon

edhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës përmes veprave muzikore shqiptare dhe ato botërore.


Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënës në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënës të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimi të muzikës do të thotë që nxënës të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efikase në orën e muzikës janë *brainstorming*, *klaster*, *harta e të pyeturit*, *diagrami i venit*, *ddm*, *harta e koncepteve*, *kubimi*, *insert* etj.

6.2. Teknika të mësimdhënies

6.2.1 Kllasteri


Kllasteri, ose grupimi i mendimeve që ndonjëherë në literaturë emërtohet “harta e mendimeve”, është një teknikë që i nxit nxënës të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një



mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë dhe plotësuar ato më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore.

6.2.2. Rrjeti i diskutimit

Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të kuptuar përmbajtjen muzikore të veprave dhe krahasuar ato. Përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit. Sipas kësaj teknike, klasa ndahet në dy grupe (“pro” dhe “kundër”). Diskutimi midis grupeve vazhdon 15-25’, sipas temës dhe mund të realizohet me nxënës të çdo moshe.



6.2.3. Brainstorming:

Brainstorming është një veprimtari që bën pjesë në **stilin pamor** por edhe **dëgjimor**, duke iu përshtatur lëndës së muzikës sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim CD, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera.


Qëllimi i përdorimit të brainstorming-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. Brainstorming-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera dhe nga një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura. P.sh. Shkruhet në dërrasë të zezë fjala *Trashëgimia kulturore shqiptare*, ku nxënësve u kërkohet të flasin rreth asaj që dinë mbi trashëgiminë kulturore shqiptare *materiale dhe shpirtërore*, duke sjellë informacion mbi muzikën e krahinës së vet, por edhe duke e krahasuar me muzikë të krahinave të tjera. Kjo teknikë kërkon të mbahet parasysh:

- Asnjë prej zgjidhjeve e ideve të mos kritikohet.
- Të nxiten nxënësit të shprehin ide.
- Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura.

- Të aktivizohen edhe nxënës të ndrojtur.
- Të shërbejë si nxehje e trurit.

6.2.4. Kubimi:

Kubimi është një teknikë që mund të bëjë pjesë në **stilin dëgjimor** sepse përmes vendosjes së një veprë dëgjimore shqiptare, ndihmon shqyrtimin e veprës nga këndvështrime të ndryshme, për shkak të përjetimit emocional që është i ndryshëm tek gjithësecili. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa të shkurtra: *Përshkruaje, krahasoje, shoqëroje, analizoje, argumentoje (pro ose kundër)* p.sh.: Vepër muzikore, këngën, muzikën popullore, dy kompozitorë, ku nxënësit udhëzohen të mendojnë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të mësuesit dhe ta përshkruajnë atë: (forma muzikore, karakteri i veprës, subjekti që trajton vepra, etj.)




6.2.5. Tabela e koncepteve:

është një teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, një teknikë racionale për të organizuar informacionin muzikor përmes dëgjimit dhe krahasimit të disa veprave muzikore. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndhmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizmin e skemave të qarta, që sigurojnë qëndrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet apo njohuritë muzikore, që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet ky krahasimi i veprave muzikore.

Format muzikore instrumentale		
simfonia	sonata	koncerti

6.2.6. Diagrama e Venit

Diagrama e Venit është teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor** më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore, formave muzikore, ngjarjeve muzikore, kompozitorëve të ndryshëm, 2 periudhave muzikore etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Npërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.




6.2.7. Harta e të pyeturit

është teknikë **që i përket stilit pamor dhe dëgjimor**, është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit e cila shoqërohet me fragmente të ndryshme muzikore.

Përparësitë:

- *Hap rrugën për diskutim.*
- *Ndihmon nxënësit për të zhvilluar aftësi më të mëdha të të menduarit.*
- *Tërheq nxënësit në punët e pavarura.*
- *Rrit rolin e nxënësve në mësim.*
- *Nxit të menduarit logjik.*
- *Nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.*



Si të krijojmë një hartë të pyeturi? Për të përpiluar një hartë të pyeturi, mund të ndiqet kjo rregullsi:

- Shkruhet tema e mësimi që do të shpjegohet në qendër të tabelës.
- Pas kësaj vizatohet harta e të pyeturit, në të cilën pas pyetjeve kyç, gjenden të lidhura edhe pyetje të tjera që zgjerojnë hartën.

6.2.8. Teknika “Përdorimi i teknologjisë / interneti

Teknologjia përfshin përdorimin e programeve kompjuterike, ndërsa interneti mund të përfshijë Word, Web, postë elektronike (e-mail), etj. Është një burim i dobishëm informacioni për shumë tema dhe një mjet komunikimi me njerëzit. Nxënësi duhet të përdorë aftësi specifike të nevojshme për të hyrë në informacion në internet dhe më shumë e rëndësishme është vlerësimi në mënyrë kritike i informacionit të grumbulluar. Përdorimi i programeve të ndryshme PowerPoint etj.

6.2.9. Teknika “Di – Dua të di – Mësova”

Në temën “**Muzika në periudhën e romantizmit**” nxënësi plotëson kolonat e tabelës sipas tri fazave kryesore të orës së mësimi.

Di?	Dua të di?	Mësova
<i>Krijimtaria muzikore romantike ishte shumë e larmishme në motive .</i>	<i>A pasqyroi çdo kompozitor në veprat e veta motivet folklorike të vendit të vet?</i>	<i>Kompozitorët romantikë të muzikës instrumentale dhe vokale pasqyruan në veprat e tyre folklorin e vendit të tyre.</i>
<i>U zhvillua shumë muzika vokale operat e Verdit.</i>	<i>A u zhvillua po kaq fuqishëm edhe muzika instrumentale?</i>	<i>Muzika instrumentale dhe ajo vokale vendosën tipare të reja dhe u lëvruan nga kompozitorët romantikë.</i>
<i>U shquan shumë kompozitorë në romantizëm.</i>	<i>A paraqitën individualitet kompozitorët përmes veprave të tyre?</i>	<i>Çdo kompozitor i romantizmit pasqyroi individualitetin në krijimet muzikore dhe kombëtar.</i>

6.2.10 Teknika “Hulumtimi”

Një nga mënyrat më të mira për të mësuar rreth muzikës është që nxënësi të mendojë për pyetje, të cilat i interesojnë. Kjo do të thotë që nxënësi të bëjë kërkime për të gjetur përgjigjet e këtyre pyetjeve. Ka disa hapa që përdoren për kryerjen e hulumtimeve dhe rezultatet më të mira arrihen në qoftë se nxënësit bëjnë gjërat në rendin e duhur dhe pyesin në vijim me pyetje.

Përcaktimi

- Çfarë dua të zbuloj?
- Cili është qëllimi im?
- Cilat janë fjalët kyç dhe idetë kryesore të kësaj detyre?
- Çfarë duhet të bëj unë?
- Ku mund të gjej informacionin që kam nevojë?
- Çfarë di unë tashmë?
- Çfarë kam ende nevojë për të gjetur?

Përzgjedhja

- Çfarë informacioni duhet në të vërtetë?
- Çfarë mund të lë jashtë?
- Sa i rëndësishëm është informacioni që kam gjetur?
- Sa i besueshëm është informacioni që kam gjetur?
- Si do ta shënoj të gjithë informacionin?

Organizimi

- Si mund ta përdor më mirë këtë informacion?
- A duhet ta përdor të gjithë informacionin?
- Si mund të kombinoj më mirë informacionin nga burime të ndryshme?

Prezantimi

- Si mund ta paraqes këtë informacion?
- Me kë do ta ndaj këtë informacion?
- Si ndikon publiku në prezantimin tim?

Vlerësimi

- Çfarë mësova nga e gjithë kjo?
- A kam arritur atë që përcaktova për të arritur?
- Si kam shkuar me prezantimin e informacionit tim?

- Çfarë mund të vazhdoj akoma?

Hulumtimi me temë “Zhanre muzikore, vepra dhe përfaqësues”

Koncepti i një zhanri në muzikë qëndron në kufirin e kategorive të përmbajtjes dhe formës dhe lejon të gjykohet përmbajtja objektive e një veprë bazuar në kompleksin e mjeteve shprehëse të përdorura. Ai karakterizon, si rregull, gjini dhe lloje të veprave muzikore të formuara historikisht. Në muzikologji janë zhvilluar sisteme të ndryshme të klasifikimit të një zhanri muzikor, të cilat varen se cili nga faktorët që përcaktojnë zhanrin konsiderohet si kryesori. Shpesh, e njëjta vepër mund të karakterizohet nga këndvështrime të ndryshme, ose një zhanër i njëjtë mund t'i atribuohet disa grupeve zhanre. Është e mundur të veçohen "zhanre brenda zhanreve", për shembull, zhanre të ndryshme të muzikës vokale dhe instrumentale të përfshira në opera. Opera, nga ana tjetër, është në thelb një zhanër sintetik që ndërthur lloje të ndryshme arti. Prandaj, gjatë klasifikimit, duhet të kihet parasysh se cili faktor ose kombinim i disa faktorëve është vendimtar. Tiparet e zhanrit mund të ndërthuren: për shembull, zhanret e këngës dhe kërcimit. Përbërja e interpretuesve dhe mënyra e performancës përcaktojnë klasifikimin më të zakonshëm të zhanreve. Kjo është, para së gjithash, ndarja në zhanre vokale dhe instrumentale. Disa zhanre kanë histori komplekse që e bëjnë të vështirë klasifikimin. Kështu, një kantatë mund të jetë një vepër solo dhome dhe një vepër e madhe për një kompozim të përzier (xop, solistë, orkestër).

Llojet e zhanreve muzikore - klasifikimi.

Klasifikimi më i thjeshtë i zhanreve është **me anë të ekzekutimit...** Këto janë dy grupe të mëdha:

Instrumentale (marsh, vals, etyd, sonatë, fugë, simfoni);

zhanret vokale (arie, këngë, romancë, kantatë, opera, muzikore).

Familje masive zhanret (varietetet e këngës, marshimit dhe vallëzimit: polka, vals, ragtime, baladë, himn) - ndryshojnë në një formë të thjeshtë dhe intonacione të njohura;

Zhanret e koncerteve(oratorio, sonatë, kuartet, simfoni) - shfaqje tipike në një sallë koncertesh, ton lirik si vetë-shprehje e autorit;

Oratorio- një pjesë kryesore muzikore për kor, solistë dhe orkestër. Ai ndryshon nga opera në mungesë të veprimit skenik, dhe nga kantata - në madhësinë e saj më të madhe dhe degëzimin e komplotit.

Sonatë është një zhanër i muzikës instrumentale, si dhe një formë muzikore e quajtur forma e sonatës. Kompozuar për instrumente dhome dhe piano. Zakonisht solo ose duet.

Kuarteti- një ansambël muzikor me 4 muzikantë, vokalistë ose instrumentistë.

Simfonia (Greqisht "konsonancë", "eufoni") - një pjesë muzikore për një orkestër. Si rregull, simfonitë shkruhen për një orkestër të madhe me përbërje të përzier (simfonike), por ka edhe simfoni për orkestra me harqe, dhomë, tunxh dhe orkestra të tjera; Në simfoni mund të përfshihen zërat e korit dhe vokalit solo.

Muzikë Popullore, folklori muzikor ose muzika popullore

Muzika shpirtërore- vepra muzikore që lidhen me tekste të natyrës fetare, të destinuara për interpretim gjatë një shërbimi kishtar ose në jetën e përditshme.

Muzike klasike(nga lat. *classicus* - shembullor) - vepra muzikore shembullore të kompozitorëve të shquar të së kaluarës, të cilat i kanë rezistuar kohës. Vepra muzikore të shkruara sipas rregullave dhe kanuneve të caktuara në përputhje me përmasat e nevojshme dhe të destinuara për t'u interpretuar nga një orkestër simfonike, ansambël ose solist.

Muzika e Amerikës Latine(Muzika spanjolle latino americana) është një emër i përgjithësuar për stilet dhe zhanret muzikore të vendeve të Amerikës Latine, si dhe muzikën e emigrantëve nga këto vende, që jetojnë kompakt në territorin e shteteve të tjera dhe formojnë komunitete të mëdha të Amerikës Latine (për shembull, në SHBA).

Blues është një stil muzikor i krijuar nga muzikantë me ngjyrë që jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bluzi u luajt për herë të parë në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë në shtetet jugore, në afërsi të Deltës së Missisipit. Muzika e këtij stili është shumë e larmishme, shumë muzikantë kanë krijuar stilin e tyre të performancës.

Jazz (Xhazi anglez) është një formë e artit muzikor që u ngrit në fund të shekullit të 19-të - fillimi i shekullit të 20-të në Shtetet e Bashkuara si rezultat i sintezës së kulturave afrikane dhe evropiane dhe më pas u përhap. Tiparet karakteristike të gjuhës muzikore të xhazit ishin fillimisht improvizimi, poliritmi i bazuar në ritme të sinkopuara dhe një grup teknikash unike për kryerjen e teksturës ritmike - lëkundjes. Zhvillimi i mëtejshëm i xhazit ndodhi për shkak të zhvillimit të modeleve të reja ritmike dhe harmonike nga muzikantët dhe kompozitorët e xhazit.

Romanca në muzikë- një kompozim vokal, i shkruar mbi një poezi të vogël me përmbajtje lirike, kryesisht dashurie.

Muzikë rok (eng. muzikë rock) është një emër i përgjithshëm për një sërë drejtimesh të muzikës popullore. Fjala "shkëmb" - (përkthyer nga anglishtja "lëkundje, shkëmb, lëkundje") - në këtë rast tregon ndjesitë karakteristike ritmike për këto drejtime të lidhura me një formë të caktuar

lëvizjeje, në analogji me "rrokullisje", "përdredhje", "lëkundje", "Shake" dhe kështu me radhë. Disa tipare dalluese të muzikës rock, për shembull, përdorimi i instrumenteve muzikore elektrike ose vetë-mjaftueshmëria krijuese (për muzikantët rock është tipike të performojnë kompozime të përbërjes së tyre) janë dytësore dhe shpesh mashtruese.

Reggae, muzika popullore xhamajkane që u shfaq në vitet 1960 dhe është bërë e njohur që nga vitet 1970.

Muzikë pop, është një drejtim i muzikës moderne, një lloj kulture masive moderne. Është një zhanër i veçantë i muzikës popullore, domethënë, një këngë e lehtë për t'u mbajtur mend.

Si u zhvilluan zhanret muzikore?

Për të arritur në një vlerësim konkret të zhvillimit të zhanreve duhet të hulumtoni periudha, lloje, vende dhe përfaqësues. Mund të bëhet një grafik ose hartë për të kuptuar më mirë zhvillimin e zhanreve në hapësirë dhe kohë.

Hulumtoni zhvillimin e zhanreve

Provojeni!

Duke gjetur fakte të ndryshme në lidhje me zhanret muzikore përmes të dhënave dhe statistikave të ndryshme nga hulumtimi i kryer nxirren vendet, përfaqësuesit dhe zhanret më të krijuara gjatë shekujve.

Hulumtoni zhvillimin e zhanreve..... edhe në vendin tonë.

Krahasoni zhvillimin e zhanreve në botë me vendin tonë.

Çfarë do të sugjeroni për zhvillimin e zhanreve në vendin tonë ?

VII. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR


Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe i lirë në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxëniet janë një themel i

përbashkët për të gjithë mësuesit. Mësuesit përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

Tematikat janë ato që ndërtojnë kompetencat lëndore ndërsa kompetencat kyçe ndërtohen dhe zhvillohen në lëndën e muzikës. Ato janë¹:



7.1. Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën Muzikë, klasa 10/12 përfshin:

- Planifikimin vjetor,
- Planifikimin për secilën periudhë,
- Planifikimin ditor.

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor).

Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të lëndës.

7.2. Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur

¹Shkëputur nga program i Muzikës, klasa 10-të, miratuar nga MASR.

mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni. Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Periudhat nuk janë semestra, por janë periudha reflektimi për mësuesit dhe nxënësit duke reflektuar mbi punën dhe rezultatet e tyre dhe si mund të përmirësohet në vazhdim.

Shpërndarja e përmbajtjes kryesore së lëndës sipas tri periudhave, bëhet në kolonë ku vendosen përmbajtja kryesore e lëndës që do të zhvillohet në secilën periudhë dhe për secilën tematikë. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihet njohuri, projekte, përsëritje, koncerte apo shfaqje, konkurse artistike etj., në varësi të specifikave të lëndës. Lënda e muzikës si lëndë me zgjedhje, në kurrikulën me zgjedhje të detyruar në klasën X, XI, ose XII, zhvillohet në 36 javë mësimore me nga 2 orë në javë, pra gjithsej 72 orë në klasat 10-11 –të dhe 34 orë klasa 12-të. Programi i lëndës së muzikës specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë, ku shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Planifikimi vjetor në lëndën e muzikës, klasa 10-të

Tematikat	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknika dhe procese	Historia, muzika dhe shoqëria	Totali
Orët sipas tematikave	15 orë	30 orë	27 orë	72 orë

Realizimi i tri llojeve të planifikimit kërkon realizimin gjatë procesit të mësimdhënies edhe të disa rubrikave që përmban program mësimor. Ato janë:

- Ndërtimin e *kompetencave kyçe*.
- Ndërtimin e *kompetencave lëndore*.
- Përfshirjen dhe ndërthurjen e *temave ndërkurrikulare*.
- Përfshirjen dhe ndërthurjen e *fushave/lëndëve të tjera*.

Planifikimi vjetor, në lëndën e muzikës, klasa 10-të.

SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
Shtator – Dhjetor 24 orë	Janar – Mars 24 orë	Prill – Qershor 24 orë
Gjuha dhe komunikimi muzikor (15 orë)	Teknika dhe procese (30 orë)	Historia, muzika dhe shoqëria (27 orë)
1.1.1.Muzika dhe kultura e popujve	2.1.Koralja “Ave Maria”J.S.Bach	3.1.Muzika në mesjetën e lulëzuar (shek XI –XV)
1.2.Muzika dhe lufta	2.2.Përsëritje e koralet	3.2.Kultura muzikore gjatë Rilindjes
		3.3. Shkollat polifonike
		3.4. Kultura muzikore në Evropë gjatë periudhës së barokut
1.1.3.Muzika dhe puna	2.3.Kënga “Lule bore” S.Gjoni	3.5.Kompozitorët gjatë periudhës së barokut J.S.Bach dhe ZH.F Hendel
1.1.4.Muzika dhe shëndeti	2.4. Përsëritje e këngës	3.6.Kultura muzikore gjatë periudhës së klasicizmit
1.5.Muzika dhe ju - përmbledhje	2.5. “Në qetësinë e natës” J. Brahms	3.7.Kompozitorët në klasicizëm Hajden, Mozart, Beethoven
1.6.Muzika dhe sporti	2.6.Përsëritje e këngës	3.8. Dëgjime muzikore dhe reflektime
1.7.Muzika dhe kërcimi	2.7. “Moj e bukura More” – R. Dhomi	3.9.Kultura muzikore në Evropë gjatë periudhës së romantizimit
1.8.Muzika e filmit dhe e reklamave	2.8. Përsëritje e këngëve	3.10.Kompozitorët F. Schubert, F. Chopin, F. Liszt
1.9. Muzika dhe ju - përmbledhje	2.9. “ Koralja “Oda e gëzimit” L.V.Beethoven	3.11.Kompozitorët gjatë periudhës së romantizmit, muzika vokale
1.10.Struktura muzikore	2.10. Përsëritje e këngëve	3.12. Dëgjime muzikore dhe reflektime
1.11.Format muzikore	2.11. Përsëritje e këngëve	3.13.Muzika gjatë shekullit XX
1.12.Format 1-2-3 pjesëshe	2.12. Përsëritje e këngëve	3.14. Muzika modern
1.14. Muzika dhe ju - përmbledhje	2.13. Përsëritje e këngëve	3.15. Muzika shqiptare në lashtësi dhe mesjetë

1.15. Përdorni njohuritë tuaja	2.14. Përsëritje e këngëve	3.16. Muzika në periudhën e rilindjes
1.16. Zëri instrumenti ynë natyror	2.15. Përsëritje e këngëve	3.17. Përfaqësues të muzikës shqiptare në gjysmën e parë të shek 20
1.17. Rregullat e këndimit	2.16. Përsëritje e këngëve	3.18. Dëgjime muzikore dhe reflektime
1.18. Këndimi dhe formacionet vokale	2.17. Përsëritje e këngëve	3.19. Muzika profesioniste shqiptare në gjysmën e dytë të shek 20-të
1.19. Këngë të rrymave të ndryshme muzikore - Elvis Presly	2.18. Përsëritje e këngëve	3.20. Muzika profesioniste kosovare
1.20. Grupi Bitellsat - Image	2.19. Muzika në Mesopotami, Egjipt, Indi dhe Kinë	3.21. Muzika vokale profesioniste shqiptare & Muzika e lehtë shqiptare
1.21. Këngëtarët shqiptarë	2.20. Muzika në Greqinë dhe Romën e lashtë	3.22. Projekt
1.22. Projekt	2.21. Muzika në mesjetën e hershme	3.23. Projekt
1.23. Projekt	2.22. Projekt	3.24. A) Shfaqje koncertore ose B) detyrë përmbledhëse.
1.24. A) Shfaqje koncertore ose B) detyrë përmbledhëse.	2.23. Projekt 2.24. A) Shfaqje koncertore ose B) detyrë përmbledhëse.	
24 orë	24 orë	24 orë

7.3 Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planifikimin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para

fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës.

Në planet sipas periudhave, planifikohen të gjitha orët.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënit, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së Muzikës”.

b) Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxëni nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës së Muzikës.

c) Numri rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës së Muzikës.

d) Tematika

Në këtë rubrikë shënohen tematikat mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës Muzikës.

e) Tema mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban:

Orë të detyruara për t’u planifikuar

- temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit. Mësuesi orientohet sipas tekstit mësimor;
- orët e projektit kurrikular që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e muzikës si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyçe. Mësuesi në varësi të kushteve specifike mund të planifikojë në lëndën e muzikës të paktën 3 deri në 6 orë projekt kurrikular (për të gjithë vitin akademik);
- orë ushtrimesh muzikore, përpunim njohurish etj., për të konsoliduar dhe zbatuar njohuritë dhe aftësitë e fituara në lëndën e muzikës;
- orët e **detyrave përmbledhëse** për të matur njohuritë dhe aftësitë e fituara nga nxënësit në periudhën përkatëse. Mësuesi planifikon 3 detyra përmbledhëse, nga një për çdo periudhë. Detyrat përmbledhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit e

tij, d.m.th jo detyrimisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha.

f) Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi **nuk** zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., Kllaster, Diagrama e Venit, Kubimi, Tryeza e diskutimit, Harta e konceptit, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h) Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

i) Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënit si p.sh., teksti i nxënësit, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

Planifikimi i orëve mësimore për një periudhë, klasa X

Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit (shkëputur programi mësimor – Muzika 10/12)	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	
▪	Zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike.

- Gjykon drejt mesazhin artistik.
- Shprehet nëpërmjet një komunikimi të qartë dhe saktë me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe formave muzikore.
- Shfrytëzon mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.

Kompetenca e të menduarit

- Përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.
- Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike.
- Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.
- Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore artistike.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

- Vendosi mjetet në funksion të realizimit të krijimit muzikor.
- Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.
- Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- Merr përsipër ose drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

- Krijon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.
- Merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet.
- Ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimit dhe krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

- Promovon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
- Respekton punën e të tjerëve.
- Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

Kompetenca digjitale

- Shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.
- Përdor një mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënës (shkëputur nga programi mësimor –

Muzika 10)

Krijimi muzikor		Performimi/interpretimi muzikor			Vlerësimi muzikor	
Nxënësi/ja: - përdor ide të ndryshme për të organizuar mendimin e tij personal estetik muzikor; - zhvillon mendimin e tij personal mbi elementet muzikor gjatë analizimit të veprës muzikore; - shpreh përjetimet dhe përfytyrimet muzikore gjatë dëgjimit muzikor; - organizon bindjet e veta për të shprehur mesazhin e veprës muzikore; - ndan përvojat e veta muzikore me të tjerët.		Nxënësi/ja: - përjeton emocionalisht gjatë procesit të këndimit, vepra të ndryshme (këngë, kanone, këngë popullore, arie etj), duke zhvilluar një kuptim të qartë të këndimit në grup; - përjeton emocionalisht gjatë procesit të dëgjimit, vepra të ndryshme muzikore (vokale apo instrumentale), duke zhvilluar një kuptim të qartë të veprës muzikore; - këndon motivet apo temat mjaft të njohura të pjesëve muzikore apo melodive të përzgjedhura (rinjohje nëpërmjet fishkëllimit apo këndimit të temave kryesore); - interpreton mendimin e vet mbi përmbajtjet muzikore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të saj (ese-ja); - ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.			Nxënësi/ja: - zhvillon gjykimin e vet muzikor dhe estetik mbi veprat të ndryshme muzikore; - analizon veprat muzikore (vokale dhe instrumentale) që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë duke mbështetur veçoritë e veprave muzikore; - bën krahasimin e veprave muzikore, duke u shprehur me një gjuhë të qartë muzikore dhe përdor terminologji si: melodi, ritëm, harmoni, formë etj.; - vlerëson veprat muzikore, sipas llojit, autorit, vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke ndërtuar një gjykim kritik dhe estetik.	
Përmbajtja e temave të periudhës së parë, në mënyrë të integruar						
Nr	Tematika	Tema Mësimore	Situata e të nxënit:	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burime dhe materiale
1	Gjuha dhe komunikimi	Muzika dhe kultura e popujve	Situata e të nxënit: Të përbashkëta	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive,	Demonstrimi i rezultateve	

	mi muzikor		dhe të ndryshme Vendosen disa foto nga popuj të ndryshëm që paraqesin kulturën e tyre në veshje, në kërcime, gjatë ceremonive të ndryshme dhe nxiten nxënësit të flasin rreth kulturave që ata njohin më mirë.	▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit.	të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es , materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
2	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Muzika dhe lufta	Situata e të nxënësit: Muzika dhe lufta Vendosen disa foto nga filmi artistik “Pianisti” i regjisorit Roman Polanski, ose fragmente pikante nga ky film në Dvd (nëse ekzistojnë pajisjet). Nxiten nxënësit të flasin rreth tematikës që trajton ky film. Etj.....	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es , materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.

3	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Muzika dhe puna	Situata e të nxënës: Përjetim dhe diskutim Vendoset një muzikë në sfond dhe diskutohet rreth ndikimit që krijon muzika gjatë momenteve kur ne studiojmë apo jemi duke bërë ndonjë punë. Çfarë ndodh? A ndihmon apo pengon muzika gjatë punëve që bëjmë?	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit.	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es, materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
4	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Muzika dhe shëndeti	Situata e të nxënës: Efekti Moxart Vendosen disa fragmente muzikore për dëgjim, dhe nxënësit dëgjojnë me sy mbyllur. Nxiten të flasim rreth asaj që ata ndjejnë. A ndikon muzika në momente të caktuara kur janë: mërzi, të	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit.	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es, materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.

			gëzuar të trishtuar?			
5	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Përsëritje		▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Klaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
6	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Muzika dhe sporti	Situata e të nxënësit: Sporti im i preferuar Duke vëzhguar foto nga sporte të ndryshme diskutohet rreth muzikës që i shoqëron këto lloj sportesh. Pse muzika është një element i rëndësishëm në zhvillimin e këtyre sporteve? Cila muzikë i shoqëron kryesisht këto lloj sporte?	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Klaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.

7	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Muzika dhe kërcimi	Situata e të nxënës: Kërcimi im i preferuar Vendosen disa përkufizime dhe diskutohet rreth tyre: “Kompleks lëvizjesh ritmike të trupit” “Bashkësi gjestesh dhe hapsh që i nënshtrohen një ritmi të caktuar” “Bashkësi lëvizjesh dhe hapsh të njëpasnjëshme... .” Çfarë ku kujton filmi “Step up revolution”?	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
8	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Muzika e filmit dhe e reklamave	Situata e të nxënës: Filmi dhe muzika Vendoset në Cd /Dvd kolina muzikore e filmit të Enio Morrikone-s? Nxiten nxënës të flasin rreth kësaj muzike? Sa	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.

			rëndësi ka muzika në vlerësimin e një filmi artistik? Cila është kolona zanore juaj e preferuar?			
9	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Përsëritje		- Teknika bashkëvepruese, interaktive, - Gjithëpërfshirës	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
10	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Struktura muzikore	Situata e të nxënësit: Poezia dhe muzika Recitohet një poezi dhe përcaktohet ritmi dhe motive i poezisë. Më pas merret një këngë dhe përcaktohet ritmi dhe motive i saj. Pra ritmi dhe motive janë dy elemente të përbashkëta sinë muzikë ashtu dhe poezi.	- Teknika bashkëvepruese, interaktive, - Gjithëpërfshirës - Kllaster - Harta koncepteve - Brainstorming - Diagrama Venit - Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.

11	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Format muzikore	Situata e të nxënës: Format me sy të lirë Vëzhgohen disa foto që tregojnë qartë strukturën arkitektonike të ndërtesave. Nxënësit përcaktojnë pjesët përbërëse të tyre. Po muzika ka formë? Përbëhet nga 1 pjesë apo disa?	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
12	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Format 1-2-3 pjesëshe	Situata e të nxënës: Format në art dhe format në muzikë Vendoset një pjesë në Cd dhe gjenden disa karakteristika të pjesës muzikore. Më pas vëzhgohen disa foto nga veprat e Kandiskit ku flitet për llojet e formave të përdorura në artin e tij.	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, - Cd/Dvd.

13	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Përsëritje		▪ Kuic ▪ Tryeza e diskutimit ▪ Kubimi	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es, materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi,
14	Teknika dhe procese	Kënga		▪ Këndim solo ▪ Këndimi në grup	Demonstrimi i	Teksti i nxënësit/es Kënga në cd Materiale shtesë
15	Teknika dhe procese	Zëri instrumenti ynë natyror	Situata e të nxënësit: Karakteristikat e zërit, nxënësit dëgjojnë në CD disa fragmente nga arie të ndryshme dhe përcaktojnë llojet e zërave që dëgjojnë: burrë, grua, vajzë, djalë etj.	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Klaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
16	Teknika dhe procese	Rregullat e këndimit		▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës	Demonstrimi i rezultateve të arritura	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive

				▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
17	Teknika dhe procese	Këndimi dhe formacionet vokale	Situatë e të nxënësve: Këndimi vetëm dhe në grup Nxënësit vendosen të këndojnë 1 person, pastaj 2 persona bashkë, 3 persona, 4 e më radhë deri në 8 persona. A dinë ata ti emërojnë ndryshe të kënduarit bashkë?	▪ Këndim solo ▪ Këndimi në grup ▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, figura /foto, Cd/Dvd.
18	Teknika dhe procese	Këngë të rrymave të ndryshme muzikore - Elvis Presly	Situatë e të nxënësve: Disa fakte nga jeta e Elvis Preslit Nxënësve u kërkohet të thonë disa fakte që dinë mbi mbretin e muzikës rok dhe ti rendisin ato në dërrasë të	▪ Këndim solo ▪ Këndimi në grup ▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es Kënga në CD Materiale shtesë

			zezë. Më pas këndojnë këngë nga repertori i tij.	▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit		
19	Teknika dhe procese	Grupi Bitellsat - Image	Situatë e të nxënës: Grupi im i parapëlqyer shqiptar ose i huaj Vendosen disa fragmente këngësh nga grupe mjaft të njohura shqiptare apo të huaja. Cilat janë karakteristikat e një grupi muzikor? Çfarë kanë të përbashkët apo specifike?	▪ Këndim solo ▪ Këndimi në grup ▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Gjithëpërfshirës, ▪ Kllaster ▪ Harta koncepteve ▪ Brainstorming ▪ Diagrama Venit ▪ Tryeza diskutimit	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.	Teksti i nxënësit/es Kënga në CD Materiale shtesë
20	Teknika dhe procese	Projekt	Kërkim individual rreth një këngëtari apo grupi mjaft të njohur shqiptar /huaj.	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Bashkëbisedim.	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet	Interneti Wikipedia Materiale të ndryshme burimore Foto/CD

21	Teknika dhe procese	Projekt	Kërkim individual rreth një këngëtari apo grupi mjaft të njohur shqiptar /huaj.	▪ Teknika bashkëvepruese, interaktive, ▪ Bashkëbisedim.	Demonstrimi i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet	Interneti Wikipedia Materiale të ndryshme burimore Foto/CD
22	Teknika dhe procese	Detyrë përmbledhëse	Muzika dhe të rinjtë U kërkohet nxënësve të hartojnë me shokët/qet pyetjet që do t'u bëhen të intervistuarve. Kryejnë me shokët/qet intervista në komunitet rreth llojit muzikor që pëlqejnë më shumë. Analizojnë me shokët/qet përgjigjet e marra, duke përcaktuar			

			muzikën (1 deri në 2 lloje) të parapëlqyera.			
23	Teknika dhe procese	Detyrë përmbledhëse	Muzika dhe të rinjtë U kërkohet nxënësve të hartojnë me shokët/qet pyetjet që do t'u bëhen të intervistuarve. Kryejnë me shokët/qet intervista në komunitet rreth llojit muzikor që pëlqejnë më shumë. Analizojnë me shokët/qet përgjigjet e marra, duke përcaktuar muzikën (1 deri në 2 lloje) të parapëlqyera.			

7.4 Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore. Në ndryshim nga planifikimi tradicional, në planifikimin e kurrikulës me kompetenca kemi këto ndryshime:

Planifikimi (tradicional) i orës së mësimit	Planifikimi bazuar në kompetenca i orës së mësimit
- Në planifikim përcaktohet çfarë bën mësuesi për të realizuar mësimin.	- Në planifikim përcaktohet çfarë bëjnë nxënësit ndërsa realizohet mësimi (situatat, veprimtaritë, detyrat).
- Mësimi përqendrohet pothuajse te përmbajtja.	- Mësimi përqendrohet mbi proceset dhe mbi veprimtaritë.
- Mësimi pritet të ketë të njëjtin organizim të orës së mësimit gjithmonë.	- Mësimi nuk ka të njëjtën metodologji gjithmonë. Organizimi varet nga rezultatet që duam të arrijmë.
- Roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).	- Roli i mësuesit është organizator duke mbizotëruar dhe duke e vënë theksin te bashkëveprimi i nxënësve.

Shembuj të foljeve për rezultatet e të nxënit sipas kompetencave muzikore

Folje të përgjithshme sipas taksonomisë së Blumit	Folje më specifike për ndërtimin e kompetencave
<i>kujton</i>	këndon, pranon; sjell ndërmend; identifikon; emërton, luan etj.
<i>kupton</i>	interpreton; luan, ilustron; klasifikon; përmbledh; konkludon; shpjegon; qartëson; perifrazon; paraqet; ilustron; parashikon; regjistron; lidh etj.
<i>zbaton</i>	ekzekuton; realizon, identifikon; përgjithëson; kryen; përdor; luan përmendësh, etj
<i>analizon</i>	këndon, organizon; i vë përballë; dallon; përqendron; përzgjedh; integron, skicon; analizon, liston duke analizuar, etj.
<i>vlerëson</i>	zbulon; krahason; teston; gjykon; kontrollon; kritikon;

krijon	gjeneron; planifikon; prodhon; hamendëson; ndërton; sintetizon.
---------------	---

Model i orës së mësimi, lënda Muzikë

Planifikime ditore, nga Arsimi i Mesëm i Lartë, klasa 10 -të.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të ²
Tematika: Gjuha dhe komunikimi Tema mësimore: “Muzika dhe lufta”		Situata e të nxënit: Muzika dhe lufta Vendosen disa foto nga filmi artistik “Pianisti” i regjisorit Roman Polanski, ose fragmente pikante nga ky film në Dvd (nëse ekzistojnë pajisjet). Nxiten nxënësit të flasin rreth tematikës që trajton ky film. Pse muzika është pjesë shumë e fortë e njeriut edhe në momentet më të vështira? A dinë raste të tjera ku muzika është bërë mbështetëse për njerëzit në periudha të vështira ashtu sikurse Lufta II Botërore? Nxënësit diskutojnë dhe rendisin fakte, argument dhe gjykime të qëndrueshme duke reflektuar mbi njohuritë e mara për të kuptuar rolin dhe rëndësinë e muzikës në luftë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: - përshkruan rolin dhe rëndësinë që ka muzika për të komunikuar në periudha të ndryshme. - kupton rolin e disa instrumenteve muzikore gjatë luftërave në periudha të ndryshme historike.		Fjalët kyçe: - brirët, - tamburet, - trumbetat, - këngë partizane, - big band.	

² Muzika, mund të zhvillohet në klasë të 10-të, 11-të apo 12-të, në varësi të zgjedhjes që bëhet nga nxënësit dhe shkolla. Ndaj te rubrika e shkallës dhe e klasës vendoset me ndarje p.sh.: **Klasa 10-/12 që përkon me shkallën V/VI.**

- shpjegon rolin e instrumenteve në luftë. - ndërton dhe argumenton me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore.	
Burimet: - Teksti i nxënësit/es, - Shembuj muzikore të parapërgatitura në CD. - Fragmente kryesore nga filmat e rekomanduar në tekst (Dvd).	Lidhja me lëndët e tjera: - letërsia - historia
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos disa foto apo fragmente (Dvd) nga filmi “Pianisti” i regjisorit Roman Polanski. Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth fotove apo pamjeve që shikojnë nga filmi i cili pasqyron marrëdhënien dhe rolin e muzikës në kohë lufte. Ata ngrenë çështje, argumentojnë, shpjegojnë apo reflektojnë për ngjarje, instrumente apo fakte reale analoge me atë të filmit “Pianisti”. Hapi II: foto apo fragmente (Dvd) “Gëzuar krishtlindjet” i regjisorit Kristian Karion (Christian Carion). Hapi III: ndërkohë shpjegohet pak si dhe pse muzika ka shoqëruar luftërat që në kohët e lashta. Gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, muzika kishte një funksion shumë të rëndësishëm. Në Itali lindën këngë popullore që tregonin për vuajtje dhe padrejtësi ose që rikujtonin me nostalgji jetën larg frontit të luftës. Shumë vende që ishin në luftë dërgonin artistët e tyre në kampet ushtarake, për të ngritur dhe mbajtur lart moralin e ushtarëve. Xhazi në luftë është një lloj muzike u luajt shpesh në zonat që ishin fronte lufte gjatë Luftës së Dytë Botërore, për të larguar vëmendjen e ushtarëve nga betejat. Edhe në Shqipëri gjatë dy luftërave botërore u krijuan këngë patriotike dhe më pas këngët partizane që pasqyronin idealet e kohës në të cilën u krijuan. Këto ishin kërkesat dhe idealet që kishin popujt e Evropës, gjatë kësaj periudhe.	
<i>Ndërtimi i njohurive të reja</i>	

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me (**hapin IV**), ku mësuesi vendos në CD këngë të ndryshme partizane. Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth asaj:

- çka dinë rreth këngëve partizane.
- çfarë përfaqësonin ato për kohën?
- nga kush këndoheshin?

Hapi V : Duke dëgjuar muzikë të viteve 1900 -1944, nxënësit drejtohen të gjejnë ndryshimet ose të përbashkëtat e muzikës që dëgjojnë si dhe diskutojnë me njëri - tjetrin duke ballafaquar njohuritë që kanë dhe për qëllimin në të cilën u krijuan këto këngë.

Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në *you tube* apo *internet*, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

N2: përshkrimin e rolit dhe rëndësisë që ka muzika për të komunikuar në periudha të ndryshme.

N3: shpjegimin e rolit e disa instrumenteve muzikore gjatë luftërave në periudha të ndryshme historike.

N4: ndërtimin dhe argumentimin me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore.

N4: krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë veprimtarisë mësimore.

N4: për respektimin e mendimit të mendimit të shokut/qes.

Detyra:

Detyrë hulumtuese: materiale dhe të dhëna mbi veprën muzikore Oratorio për kor dhe orkestër “Një i mbijetuar i Varshavës” të kompozitorit Arnold Shënberg (Arnold Schönberg). Punë në grupe.

Ese: Mbresat rreth kësaj veprës muzikore oratorio për kor dhe orkestër “Një i mbijetuar i Varshavës” të kompozitorit Arnold Shënberg. Punë individuale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10 /12-të
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: “Kultura muzikore gjatë periudhës së klasicizmit”		Situata e të nxënit: Vepra dhe kompozitorë Vendosen disa fjalët kyçe që përkojnë me ngjarje të kësaj periudhe apo mbi zhvillimet në tërësi etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore .	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: - Shpjegon ngjarjet historike, artistike, ekonomike, politike, që lidhen me periudhën e klasicizmit. - Shpjegon risitë e periudhës dhe zhvillimet e mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën). - Argumenton duke krahasuar një vepër të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës barok, duke renditur disa karakteristika. - Krijon linjën e kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit duke e prezantuar në klasë. - Respekton mendimin e shokëve.		Fjalët kyçe: - Klasicizëm, -opera seria - opera bufa, - simfonia, - sonata, - trio.	
Burimet: - Teksti i nxënësit. - Shembuj muzikore të parapërgatitura në CD - foto ose material të tjera.		Lidhja me lëndët e tjera: - Letërsia - Historia - Arti	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I. Brainstorming : Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi shkruan disa fjalët kyçe që përkojnë me ngjarje të kësaj periudhe apo mbi zhvillimet në tërësi etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore p.sh.: në CD *kohën e parë të simfonisë – molto allegro*, cd.

Hapi II. Teknika Pro dhe Kundër:

Pasi nxënësit e dëgjojnë nxiten të diskutojnë rreth muzikës që dëgjuan, muzikë e cila nga vetë karakteri është mjaft *allegro* si melodi. Bëhen disa pyetje:


- Si e përjetoni ju melodinë?
- Dinamikat përgjatë melodisë janë forte-piano?
- Tingëllimi shumë i shpejtë i tingujve që herë ngjiten lart dhe herë zbresin poshtë.
-

Hapi III. Teknika Tabela e koncepteve

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me, ku mësuesi shpjegon më tej rreth zhvillimeve muzikore gjatë kësaj periudhe. Gjysma e dytë e shek. XVIII njohu një revolucion të vërtetë të mendimit dhe të ideve. Kjo lëvizje me emrin *iluminizëm* (ndriçoi) nuk lindi rastësisht, por i pati rrënjët në ndryshimet ekonomiko-shoqërore që ndodhën si pasojë e revolucioneve borgjeze, veçanërisht të Revolucionit Borgjez Francez (1789) dhe të Revolucionit Amerikan (luftës për pavarësi 1776–1783).

Iluminizmi kishte si qëllim të ndriçonte mendjen e njerëzve për t'u larguar nga injoranca dhe besëtytnitë e për t'i kthyer sytë nga shkenca dhe kultura. Zbulimet e mëdha shkencore dhe përmbajtja revolucionare e ideve iluministe u bënë mbështetje e fuqishme edhe për shndërrimet në fushat shoqërore. Karakteristika kryesore të lëvizjes ideo-artistike të kësaj periudhe në Evropë është shprehja e gjendjes shpirtërore zotëruese të epokës; *e zhgënjimit dhe e pakënaqësisë ndaj realitetit ekzistues*.

*Format dhe mënyrat e shprehjes së kësaj pakënaqësie ishin të larmishme. Ato merrnin karakter dhe drejtime të ndryshme. Pikërisht për këto arsye dhe për të tjera, të cilat lidhen me gjithë lëvizjen shoqërore të kohës, kjo pjesë e shekullit do të mbyllet me periudhën e klasicizmit në muzikë, periudhë në të cilën arti muzikor fitoi tipare të reja, duke u ndarë nga stili i ngarkuar dhe plot fantazi i barokut. Kulmin e saj madhështor periudha klasike e arriti me perfeksionimin e *simfonisë* në formë dhe përmbajtje, si dhe me lindjen e një koncepti të ri e të madh muzikor siç ishte forma e *sonatës klasike*. etj...*



Hapi IV: Reflektimi

Diskutim përmbledhës

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

N 2 - lidhjen e njohurive që ka me ngjarjet historike, artistike, politike, që lidhen me periudhën e klasicizmit.

N 3 - Shpjegimin e risive të periudhës dhe zhvillimeve të mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën).

N4 - Krahasin e një vepre muzikore të së njëjtës lloj të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës Barok, duke renditur disa karakteristika.

N 4 - Prezantimin e ngjarjeve të kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit.

Detyra:

Kërkim: Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme (foto, piktura, dokumente historike) për të zgjeruar më tej njohuritë rreth karakteristikave të kësaj periudhe, duke u ndalur tek momentet që bënë jehonë.

Kërkim: Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme për të zgjeruar më tej njohuritë biografike dhe muzikore rreth përfaqësuesve të muzikës klasike dhe veprave që ata kompozuan. Krijoni album në CD me muzikën e kësaj periudhe.

Ese: Duke dëgjuar një veprat muzikore të L.V. Bethovenit apo V.A. Moxart përshkruani përjetimin tuaj emocional rreth muzikës së dëgjuar.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: “Muzika moderne”		Situata e të nxënit: Rryma që unë pëlqej më shumë Vendosen disa fjalët kyçe apo disa pjesë/këngë për tu dëgjuar në CD, që shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth zhvillimit të muzikës modern përmes rrymave dhe stileve të ndryshme gjatë shekullit 20-të. Ata nxiten për diskutime bazuar edhe në ngjarjet që ndoqën këto zhvillime, përfaqësuesit kryesorë dhe këngët që bënë epokë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: - Shpjegon rëndësinë që ka muzika modern në jetën shoqërore. - krahason <i>zëra vokale d.m.th këngëtarë, instrumentistë</i> të rrymave të ndryshme moderne. - krijon një CD me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer. - performon këngën e parapëlqyer.		Fjalët kyçe: - Moderne, - xhaz, - rok, - bluz.	


Burimet: - Teksti i nxënësit, - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD. - fragmente kryesore nga filma me jetën e këngëtarëve apo instrumentistëve (Elvis Presli, Rei Çarls; Uitni Hjuston; Xhimi Hendriks etj.) në DVD.	Lidhja me lëndët e tjera: - Historia
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos në CD për dëgjim disa nga pjesë muzikore vokale ose instrumentale të luajtura apo kënduara nga njerëz të mëdhenj të kësaj muzikë. Nxënësit gjejnë kush janë dhe diskutojnë rreth muzikës që ata luajnë apo këndojnë. Ata ndërthurin njohuritë që kanë me kohën kur u zhvilluan këto stile muzikore, ngrenë çështje, argumentojnë, shpjegojnë apo reflektojnë për ngjarje, instrumente apo fakte reale.	
Hapi I:I Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, kur mësuesi vendos në CD këngë të ndryshme dhe fillon shpjegimin . Hapi III: Ndërkohë diskuto, pyet dhe shpjegohet njëkohësisht duke plotësuar njohuritë që kanë vetë nxënësit lidhur me muzikën bluz, xhaz, rok etj. Si lindën këto lloj muzikash dhe pse u pëlqyen dhe u mirëpritën nga masat. Rhythm & Blues Muzika R&B (Rhythm and blues) është një lloj muzike shumë popullore, që gërsheton xhazin me muzikën bluz dhe u luajt për herë të parë nga artistët amerikanë me ngjyrë. Në vitin 1947 kjo lloj muzike kishte hyrë tashmë në tregun muzikor, ndërsa emri me të cilin njihet dhe sot, iu vendos në vitin 1949. Deri në fund të viteve 1950, ajo qe bërë e famshme dhe shumë kompani regjistrimi disqesh kishin prodhuar mijëra albume me këtë lloj muzike. Muzika Rock Muzika rock është një lloj muzike e përcaktuar gjerësisht, që u zhvillua në vitet 1960, me rrënjët e veta nga muzika rock ‘n’ roll dhe rockabilly, të cilat në vetvete rrjedhin nga muzika rhythm and blues,	

country dhe ndikime të tjera. Në shtesë të kësaj, muzika rock është influencuar edhe nga lloje të tjera muzike si muzika folk, jazz dhe ajo kasike.

Muzika Hip Hop, Rap

Hip Hopi është një kulturë që ka prejardhjen nga Nju Jork, DJ Afrika Bambataa ka bërë hapat e parë të kulturës së hip hop-it duke qenë MC, DJ, duke bërë “beatbox”. Së pari, hip hop-I ka filluar të krijohet nga DJ-ët të cilët kanë krijuar tingujt ritmik në dy pllaka. DJ Kool Herc është ai që ka pasur mjaft rëndësi në zhvillimin e hip hop-it. Në hip hop hyjnë : Dj-ët, reperët, grafitët, etj.. Duhet ditur që të bëhet dallimi mes hip hop-it dhe rap-it. Rap-I është pjesë përbërëse e hip hop-it, pra ai që bën muzikë rap themi se është përfshirë në hip hop. Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në *you tube* apo *internet*, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqeshme.



Në këtë temë mësimore mund të bëjë lidhjen e njohurive muzikore që nxënësit duhet të marrin me njohuritë që ata kanë marrë nga lëndët e tjera në atë vit shkollor apo në vite të tjera. Ndërthurja e njohurive bëhet natyrshëm duke shpjeguar njohuritë e reja mbi muzikën moderne dhe zhanret e reja muzikore.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

N 2 - Shpjegimin e rëndësisë që ka muzika modern në jetën shoqërore.

N 3 - Krijimin e një CD me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer.

N 4 - Krahësimin e zërave vokale *d.m.th këngëtarë, instrumentistë* të rrymave të ndryshme moderne.

N 4 - Performimin e këngës së parapëlqyer.


Detyra:

Krijim: CD me këngë të ndryshme të këtyre rrymave dhe *materiale shoqëruese biografike.*

Ese: Mbresat rreth këngëve të parapëlqyera. Punë individuale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të
Tematika: Teknika dhe procese muzikore Tema mësimore: Kënga “Për mu paska ken kismet”		Situata e të nxënit: Jaret shkodrane Kjo fjalë kyçe “jare” nxit nxënësit të flasin rreth muzikës qytetare shkodrane dhe asaj çka dinë rreth jareve. Ata këndojnë fragmente nga disa këngë. Ata sjellin emra këngëtarësh apo kompozitorësh, duke sjellë edhe fakte apo histori nga jetët e tyre.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: - Komunikon qartë informacionin që ka për <i>jaret shkodrane</i> ; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;		Fjalët kyçe: - Jare, - melodia e këngës, - teksti i këngës, - rregullat e këndimit, - muzika qytetare shkodrane.	

- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - këndon vetëm dhe në grup.	
Burimet: - Teksti i nxënësit, - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, - figura /foto, - kënga në cd.	Lidhja me lëndët e tjera:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> <i>Hapi I: Teknika kllaster</i> Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos për nxënësit të dëgjojnë në CD disa fragmente nga <i>jare të ndryshme shkodrane</i>. Përmes tyre nxënësit nxiten të flasin rreth muzikës qytetare shkodrane dhe asaj çka dinë rreth jareve. Ata këndojnë fragmente nga disa këngë. Ata sjellin emra këngëtarësh apo kompozitorësh, duke sjellë edhe fakte apo histori nga jetët e tyre. Në temën mësimore kënga “Për mu paska ken kismet”, mësuesi mund të bëjë lidhjen e njohurive muzikore që nxënësit duhet të marrin me njohuritë që ata kanë marrë nga lëndët e tjera në atë vit shkollor apo në vite të tjera. Ndërthurja e njohurive bëhet natyrshëm duke shpjeguar njohuritë e reja mbi muzikën popullore. Kështu hapat që ndjek mësuesi për të realizuar këtë orë mësimore janë si më poshtë: <i>5 minuta, Hapi I: Brainstorming</i> - Mësuesi shkruan në tabelë fjalën <i>muzika popullore – këngët</i> dhe pret nga nxënësit të gjitha përgjigjet e mundshme që ata kanë për këtë lloj muzike. <i>30 minuta, Hapi II: Kllaster</i> - Mësuesi shkruan ose parapërgatit në një flipchart të gjithë të dhënat e mëposhtme dhe diskuton me nxënësit njohuritë që ata kanë mbi këngën popullore shkodrane -jaret, por edhe duke plotësuar njohuritë që ata nuk kanë për të.	



Veprimtaria mësimore vazhdon më tej ku mësuesi **vendos** në CD për dëgjim jare “ Për mu paska ken ksimet”. **Nxiten** nxënësit të flasin duke thënë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe do të krijonte emocion vetëm nga fjalët e tekstit apo edhe përmes muzikës? Apo përmes të dyjave së bashku?

Vendoset përsëri kënga dëgjim dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj , sipas hapave të mëposhtëm:

- Këndimi varg pas vargu,
- përsëritja e vargjeve herë pas here,
- këndimi i strofës,
- këndimi i strofës dhe refrenit,
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund,
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion,
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

Gjatë mëimit të këngës, kujdes të respektohet *ritmi, intonacioni, interpretimi* i këngës.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në*:

N 2 - Komunikimin e qartë të informacionit që ka për *jaret shkodrane*;

N 3 - këndimin duke respektuar rregullat e përcaktuara;

N 4 - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;

N 4 - këndimin vetëm dhe në grup.

Detyra:

Ese /Krijim individual:

- a) Kërkim nga burime të ndryshme muzikore interpretime nga këngëtarë të ndryshëm shkodranë (krijim i CD) ose
- b) përshkrim i emocioneve nga këngë të ndryshme shkodrane.

VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN MUZIKË

Qëllimi kryesor i vlerësimit është ***përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve*** nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit ***mbledhjen e dhënave dhe gjykohe për vlerën*** e arritjes së rezultateve të të nxënësve, duke u bazuar në nivelet e arritjes.

Vlerësimi përdoret:

- për të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve për të nxënë;
- për të motivuar dhe për të nxitur nxënësin për të nxënë;
- për të gjykuar, reflektuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënies -nxënies;
- për të matur arritjet e nxënësve;
- për të raportuar arritjet;
- për t'u dhënë sugjerime nxënësve për përmirësimin e tyre;
- për t'u dhënë sugjerime prindërve mbi përmirësimin e fëmijëve të tyre.

Vlerësimi në muzikë mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënësve të përshkruara në programin mësimor. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësve dhe mund të integrohet në të nxënësve normal të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve kryhet nëpërmjet:

- ☒ vlerësimit të vazhduar;
- ☒ vlerësimit me detyrë përmbledhëse;
- ☒ vlerësimin me projekt kurrikular.

8.1 Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)

- Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënit, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe në gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe në debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
- Mësuesi vlerëson nxënësin me notë në regjistër, vetëm pasi është siguruar që ky vlerësim është objektiv dhe shpreh shkallën e qëndrueshmërisë së performancës së nxënësit për një periudhë të caktuar kohe. Për këtë qëllim, mësuesi përdor fletoren e tij personale të regjistrimit të përgjigjeve të nxënësit, për të argumentuar në çdo kohë, objektivitetin e vlerësimit të tij me notë në regjistër.
- Fletorja personale e mësuesit nuk është objekt monitorimi.
- Mësuesi shënon në regjistër të paktën 2 (dy) vlerësime me notë për çdo periudhë.
- Mësuesi nxjerr notën e vlerësimit të vazhduar për çdo periudhë duke u bazuar në notat e nxënësit në regjistër dhe në shënimet që ka mbajtur në fletoren e tij personale. Mësuesi merr në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënit në programin lëndor.
- Mësuesi ka përgjegjësi për të informuar prindërit dhe nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e nxënësit për progres.

8.2 Vlerësimi i të nxënit (Detyra përmbledhëse)

Vlerësimi i të nxënit quhet shpesh vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Zakonisht planifikohet në fund të një njësie apo të një periudhe të caktuar. Ky është një vlerësim **formal** dhe kryhet edhe për efekt raportimi. Në përfundim të periudhës (kur e vendos mësuesi) kryhet **vlerësimi me detyrë përmbledhëse**, i cili ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse. Detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë.

Si dhe kur realizohet detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet **vlerësimi me detyrë përmbledhëse**, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi, kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është **i lirë** dhe ka fleksibilitet ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë (jo domosdoshmërisht bëhet në fund të periudhës).
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Detyra përmbledhëse **jo domosdoshmërisht** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
- Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor detyrat përmbledhëse.
- Vlerësimi i detyrës përmbledhëse pasqyrohet në regjistër, në kolonën përkatëse.

Vlerësimi i të nxënit ndryshe apo vlerësimi përmbledhës në lëndën e muzikës **duhet të zhvillohet më shumë nëpërmjet një aktiviteti gjithëpërfshirës** p.sh.: koncert me tematikë të caktuar, detyrë në grupe, krijim muzikor, konkurs midis skuadrave për performim dhe njohuri muzikore ku secili ka një rol të caktuar në detyrën e vet. motivimi përkufizohet si, “veprimi ose procesi i dhënies së një arsye dikujt për të bërë diçka”. Pse do të prisnim që një nxënës të bëjë diçka pa ndonjë arsye? Kjo është ajo ku nxitet motivimi i nxënësve. Konkursset, në përgjithësi, konsiderohen si një pjesë e rëndësishme e shkollës kryesisht për nxënësit shumë të mirë dhe të talentuar. Konkursset përdoren më së shumti për të demonstruar aftësi fizike dhe sportive të ndjekura nga aftësi intelektuale/akademike.

Në fakt, në këtë udhëzues konkursset do t’i shohim **si formë** për të ushtruar strategjitë e të nxënit. Ky lloj konkursi i ofrohet të gjithë nxënësve për të konsoliduar njohuritë mbi veprat muzikore, përfaqësuesit. Ngjarjet dhe konteksti historik etj., dhe i jep mundësi atyre për të përmirësuar arritjet personale në lëndën e muzikës. Konkursi shikohet si një mënyrë apo teknikë e procesit të nxënies për sigurimin e një mjedisi inkurajues dhe motivues në të cilin të gjithë nxënësit konkurrojnë duke rritur aftësitë e të nxënit të tyre si dhe ndjenjën e autonomisë.

Qëllimet kryesore të konkurseve në klasë në lëndën e muzikës janë rritja e motivimit, emocioneve dhe interesimit për muzikën. Përgatitja për një konkurs në muzikë mund të kërkojë formë e pavarur, pasi shumë konkurse kërkojnë përgjigje të shpejta dhe të sakta nën presion. Ato mund të

përfshijnë aktivitete të zgjidhjes së problemeve në grup ku puna ekipore dhe bashkëpunimi janë të rëndësishme. Është e rëndësishme të theksojmë që konkursi mund të drejtohet, të zhvillohet dhe të vlerësohet nga vetë nxënësit.

Detyra përmbledhëse, ka për qëllim të masë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënit.

- Mësuesi përzgjedh të zhvillojë detyrë përmbledhëse, sipas disa veçorive të lëndës.
- Detyra përmbledh përmban vetëm rezultatet e të nxënit (njohuritë dhe shkathtësitë) kryesore të periudhës përkatëse.
- Koha e realizimit të detyrës përmbledhëse është 45 min.

Detyra përmbledhëse mund të jetë:

- Konkurs me njohuritë përmbledhëse muzikore të periudhës p.sh.: Shtator - dhjetor.
- Krijimtari muzikore me krijimin e kompozuar.
- Krijimtari muzikore për esenë e krijuar nga tekstet e këngëve apo veprën muzikore të parapëlqyer e dëgjuar gjatë periudhës.
- Konkurs midis skuadrave për njohuritë muzikore të marra.
- Përshkrim emocional, mbi një vepër muzikore/këngë duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor.

Shembull për konkursin midis skuadrave, Periudha I, klasa 10-të

Pyetja 1: Ku u zhvilluan shkollat polifonike në Evropë?

Pyetja 2: Thoni emrin e muzikantit që emërtoi notat muzikore.

Pyetja 3: Thoni si përbëhej Kori Georgian gjatë këndimit *burra, gra apo fëmijë*.

Pyetja 4: Me çfarë lidhej muzika në periudhën e mesjetës.

Pyetja 5 : Pyetje të shpejta kuic:

- Kush është Guido D'areco?
- Çfarë përfaqëson Niket Dardani dhe Jan Kukuzeli?
- Përmend një vepër të këtyre krijuesve të muzikës?

Pyetja 6: Renditni 3 karakteristikat bazë të rilindjes.

Pyetja 7: Renditni 2 kompozitorë të periudhës së rilindjes.

Pyetja 8: Renditni 2 kompozitorë të periudhës barok.

Pyetja 9: Përshkruani 3 përjetime emocionale nga dëgjimi i veprës muzikore Tokata - fugë e Bahut.

KLASA 10-të					
TEMA: Konkurs me njohuritë muzikore të marra në periudhën /shtator - dhjetor					
Kompetenca: Krijimi muzikor		Kompetenca: Performim muzikor		Kompetenca: Vlerësim muzikor	
NJOHURI MUZIKORE		INTERPRETIM I KËNGËVE		DËGJIM MUZIKOR	
Njohuria	Pikët	Këngët	Pikët	Vepra /apo njohuri	Pikët
Muzika dhe shëndeti	2	Himni i Evropian	2	Muzika në lashtësi	2
Muzika dhe kërcimi	2	Lule bore	2	Muzika Rilindje	2
Muzika dhe lufta	2	Ave Maria	2	Muzika Mesjetë	2
Koha 2/4	2	Për mu paska ken kismet	2	Muzika Barok	2

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	13	14-15	16-17	18-19	20-21	22-23	23-24

Shembull i paraqitjes së detyrës përmbledhëse në një planifikim ditor

Tema: Konkurs me dy skuadra

Në përfundim të periudhës në muzikë një mënyrë paraqitjes së detyrës përmbledhëse është edhe shembulli i mëposhtëm. Detyra përmbledhëse zhvilluar në formën e një *konkursi* është shumë e rëndësishme mënyra sesi funksionon puna në grup dhe vlerësimi që skuadrat i bëjnë njëra tjetrës *njohurive, performimeve dhe vlerësimit të veprave muzikore*.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria. Tema mësimore: Verifiko njohuritë muzikore Konkurs muzikor me dy skuadra			
Rezultatet e të nxënit		Fjalët kyçe:	

Nxënësi: - Zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese nëpërmjet njohurive muzikore që disponon; - përdor fjalor të përshtatshëm muzikor mbi gjuhën, interpretimin dhe vlerësimin e veprave muzikore; - formulon dhe u përgjigjet saktë pyetjeve në konkurs; - shpreh mendimin e vet për rezultatet e arritura në konkurs nga skuadra.	- Njohuri muzikore; - përjetim muzikor; - vlerësim të veprave muzikore.
Burimet/mjetet/materialet: - Teksti i nxënësit; - Vepra muzikore që nxënësit kanë gjetur për të formuluar pyetjet.	-
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve	
▪ Nxënësit e klasës ndahen në dy skuadra. ▪ Çdo skuadër ka përgatitur pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. ▪ Pyetjet ndërtohen rreth njohurive të marra gjatë periudhës së parë shtator- dhjetor. ▪ Mësuesi orienton se si ata të shkruajnë pyetjet nga teksti i tyre dhe jashtë tij, por njohuri që kanë lidhje me njohuritë e marrë në muzikë. ▪ Dëgjimi dhe përgjigja e saktë mbi veprat muzikore, punë paraprake e nxënësve. ▪ Vendosin rregullat e konkurrimit dhe pikët për çdo pyetje. ▪ Hidhet shorti ku caktohet se cila nga skuadrat do të fillojë garën e para. ▪ Gjatë kohës së konkurrimit një nxënës/e mbledh pikët dhe kur skuadra që nuk i përgjigjet pyetjes ose i përgjigjet asaj pjesërisht, skuadra tjetër jep përgjigjen dhe argumenton pikët. Argumentimi i përgjigjeve dhe i pikëve është shumë i rëndësishëm gjatë konkurrimit. ▪ Në përfundim të konkurrimit përzgjidhet skuadra fituese sipas numrit të pikëve të mbledhura. ▪ Çdo skuadër diskuton konkluzionet e punës në grup dhe tregon nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin.	
Nxënësit do të vlerësohen për demonstrimin në: N2: diskutimet dhe bashkëpunimin për të realizuar pyetësoin; N3: realizimin e pyetësoin; N4: pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë zhvillimit të konkursit.	

8.3 Projekti

Projekti kurrikular në lëndën e muzikës është rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit dhe është pjesë e vlerësimit të nxënësit.

Gjatë vlerësimit me projekt kurrikular:

- Mësuesi planifikon dhe organizon një projekt të shtrirë gjatë gjithë vitit shkollor.
- Projekti kurrikular mund të jetë lëndor ose ndërlëndor, mund t'i përkasë një fushe të nxëni ose të shtrihet në më shumë se një fushë të nxëni.
- Drejtoria e shkollës menaxhon kohën e prezantimit dhe të vlerësimit të projektit kurrikular që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të vitit shkollor.
- Nota e projektit kurrikular shënohet në regjistër në kolonën përkatëse.
- Projektet e nxënësve ruhen deri në fund të vitit shkollor.

Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj. Projekti nxit të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.

Projekti kurrikular duhet të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij. Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënit që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme. Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: vërtetimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale, përpunim informacioni statistikor etj.

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij, mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

- *Tema e projektit* (Përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit)
- *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore* (Nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë).
- *Klasa/t pjesëmarrëse:* (përcaktohet klasa ose në rast se ka disa klasa).
- *Rezultatet e të nxënit* – (Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit.)
- *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:* (përcaktohen konceptet që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti).
- *Partnerët* (Nëse ka, p.sh., nëse projekti ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë për zhvillimin e muzikës vokale dhe edukimin përmes saj, një specialist i TKOB mund të jetë një partner pjesëmarrës në projekt).
- *Veprimtaritë kryesore:* (përcaktohen veprimtaritë që do të realizohen gjatë projektit).
- *Burimet kryesore të informacionit* (Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e muzikës një burim i çmuar informacioni, përveç internetit, teksteve të ndryshme janë edhe biblioteka, enciklopeditë etj.).

- *Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:* (këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. P.sh kur projekti planifikohet në 6 orë atëherë duhet vendosur tematika për të 6 orët).
- *Përshkrimi i produktit të projektit* (duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij).
- *Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi* (Mësuesi përcakton kritere për vlerësimin e projektit të cilat ia komunikon nxënësit që në fillim të projektit. P.sh., kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., në varësi të rezultateve të të nxënësit).
- *Sigurimi i të dhënave nga burime të ndryshme vlerësimi është thelbësore për të nxënëin bazuar në projekte.* Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobëta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme).

Shembull i vlerësimit të projektit kurrikular. Çdo mësues është i lirë të vendosë vetë kriteret e vlerësimit të projektit sipas tematikës që ka përzgjedhur për të realizuar me nxënësit.

Projekti ka karakter hulumtues/kërkimor - (prandaj mund të shtrihet gjithë vitin) Projekti përmban gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	<i>Niveli 1</i> Dobët 0-10 pikë	<i>Niveli 2</i> Mjaftueshëm 11 - 21 pikë	<i>Niveli 3</i> Mirë 22- 32 pikë	<i>Niveli 4</i> Shumë mirë 33 -40 pikë
(Faza e parë) 15 pikë Demonstrimi i aftësive kërkimore	0-4 pikë Nxënësit: - rrallëherë fokusohen te detyra e tyre. - Mbledhin informacione jo të përshtatshme. - Përdorin një burim për të	5-8 pikë Nxënësit: - dalin jashtë temës dhe nuk fokusohen vetëm te detyra e tyre. - Mbledhin informacion dhe	9-12 pikë Nxënësit: - janë të fokusuar te detyra e tyre shumicën e kohës. - Mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde.	13-15 pikë Nxënësit: - janë të fokusuar te detyra e tyre. Vetëorientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. - Mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe krijojnë komente

	gjetur informacionin.	përmbledhin ato. - Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	- Përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	intuitive për të zgjidhur probleme. - Përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
(Faza e dytë) 15 pikë Realizimi i kërkimit të gjetur	0 -4 pikë Nxënësit: -rrallëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit. - informacioni i gjetur shpeshherë është jo i saktë.	5– 8 pikë Nxënësit: - ndonjëherë përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit, por jo në mënyrë të vazhdueshme. - Shtjellimi i kërkimit është me gabime.	9 – 12 pikë Nxënësit: - zakonisht përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit të përshtatshme dhe efektive. - Shtjellimi i kërkimit përmban pak gabime.	13 – 15 pikë Nxënësit: - përdorin gjatë gjithë projektit përdorin mënyra të përshtatshme në shtjellimin e kërkimit të përshtatshme dhe efektive. - Shtjellimi i kërkimit është i saktë dhe i qartë.
(Faza e tretë) 10 pikë Prezantimi në mënyrë efektive i projektit	0-2 pikë - Prezantimi i materialit është i çorganizuar dhe rrëmujë - Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri-tjetrin. - Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.	3 -5 pikë - Prezantimi i materialit është i organizuar mirë punën e tyre - jo gjithmonë të krijojnë lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari. - Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.	6-8 pikë Prezantimi i materialit është organizuar mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijojnë lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.	9-10 pikë - Prezantimi i materialit është organizuar shumë mirë punën e tyre që të krijojnë lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari. - Rezultatet e projektit prezantohen qartë.

Shembull i vetëvlerësimit ose e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Edhe ky shembull është një model që shërben për të orientuar çdo mësues dhe nxënës rreth vlerësimit. Edhe në këtë rast çdo mësues është i lirë të vendosë kriteret sipas tematikave që për zgjedh të zhvillojë.

Projekti kurrikular Gjithsej 40 pikë (nëse projekti shtrihet gjithë vitin)					
Kriteret e vlerësimit	Treguesi	ShM	M	Mj	D
15 pikë (Faza e parë) Demonstrimi i aftësive kërkimore	▪ Demonstrimi i aftësive kërkimore.				
	▪ Bashkëpunimi në grup.				
	▪ Grupi orientohet dhe drejtohet vetë.				
	▪ Përdorimi i shumëllojshmërisë së informacioneve.				
	▪ Fokusimi te detyra e dhënë.				
15 pikë (Faza e dytë) Realizimi i kërkimit të gjetur	▪ Mbledhja e informacioneve të përshtatshme për detyrën.				
	▪ Përdorimi gjatë projektit i aftësive kërkimore të përshtatshme dhe efektive.				
	▪ Dëgjim i selektuar i veprave muzikore.				
10 pikë (Faza e tretë) Prezantimi në mënyrë efektive i projektit	▪ Përdorimi i informacionit të gjetur dhe veprave muzikore për demonstrim.				
	▪ Organizimi i materialit që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.				
	▪ Rezultatet e projektit prezantohen qartë.				
	▪ Kontribuon pozitivisht në progresin e grupit.				

Shembull projekti kurrikular me shtrirje gjithë vjetore, për lëndën e muzikës për klasën X

1. *Tema e projektit* “Muzika gjatë periudhës së klasicizmit, përfaqësues dhe vepra”
2. *Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore*: Projekti do të zgjasë gjatë tre periudhave të realizuara në 3 ose 6 orë mësimore në lëndën e muzikës, të planifikuara 1 ose 2 orë për çdo periudhë.
3. *Klasa/t pjesëmarrëse*: Klasa e X-a,b.
4. *Rezultatet e të nxënit* – Në përfundim të projektit nxënësi:
 - demonstroi njohuritë e marra për grumbullimin e të dhënave mbi muzikën klasike sipas kontekstit historik dhe kulturor të ngjarjeve;
 - lexon dhe kupton të dhënat e grumbulluara mbi muzikën klasike;
 - interpreton të dhënat dhe konsolidon njohuritë mbi ngjarjet, përfaqësuesit dhe veprat muzikore në periudhën e klasicizmit;
 - dëgjon vepra muzikore dhe shpreh përjetimin e vet emocional, duke shpjeguar ndjesinë emocionale ;
 - përdor terminologjinë e duhur muzikore për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar informacionin dhe ndjesinë muzikore në vepra të ndryshme muzikore të krijuara gjatë periudhës së klasicizmit;
 - bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shpjegimit të veprave muzikore por edhe të përfaqësuesve të tyre;
 - prezanton para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërrshetur format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
 - bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht me grupin.
5. *Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit*:
 - a. Dëgjimi i veprave, qëllimi i studimit;
 - b. grumbullimi i informacionit dhe të dhënave;
 - c. përpunimi i informacionit dhe të dhënave;
 - d. paraqitja grafike e të dhënave;
 - e. interpretimi i të dhënave, klasifikimi i veprave për prezantim;
 - f. prezantimi i tyre.

6. Partnerët që do marrin pjesë në projekt – prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

7. Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit.
- Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup.
- Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.
- Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup.
- Kërkime njohurish të nevojshme në literaturën e rekomanduar, apo në internet në mënyrë që nxënësit të shfaqin aftësitë e tyre hulumtuese dhe studimore.
- Hartimi i pyetësorit (intervistave), përcaktimi i popullatës dhe përzgjedhja e kampionit në të cilën do të kryhet pyetësi (intervistat).
- Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, (intervistat), komunikimi me mësuesit, prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënësit sipas popullatës së përzgjedhur.
- Përpunimi i të dhënave.
- Ndërtimi i tabelave, diagrameve etj.
- Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.
- Hartimi i draftit përfundimtar të projektit si rezultat i punës në grup dhe individuale.
- Prezantimi i produktit përfundimtar dhe dorëzimi i punës që ka bërë gjithsecili nga nxënësit.

8. Burimet kryesore të informacionit:

- Informacioni i marrë nga interneti (kërkim mbi ngjarje, biografi dhe vepra muzikore);
- materiale audio nga interneti (you tube);

9. Baza materiale:

- Letra të bardha;
- Kartonë;
- Lapustila;
- CD;
- Foto;
- DVD etj.;

10. Tematika e orëve të planifikuara (me 1 ose 2 orë):

- Ora 1 dhe 2.** Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.
- Ora 3 dhe 4.** Përpunimi i materialit të grumbulluar, zhvillimi i të dhënave nga kërkime të ndryshme, ppt etj..
- Ora 5 dhe 6.** Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij. Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

Përshkrimi i produktit të projektit

Projekti do të përmbajë krijimin e një historiku të muzikës klasike, bazuar në vepra dhe përfaqësues. Për të realizuar këtë projekt nxënësit do të mbledhin informacione që lidhen me detyrën hulumtuese që ka secili grup. Detyra hulumtuese ka të bëjë me studimin e zhvillimit të muzikës gjatë periudhës së Klasicizmit, veprat kryesore, format dhe gjinitë që u zhvilluan si dhe përfaqësuesit që lëvruan këto gjini dhe forma gjatë kësaj periudhe.

Gjatë këtij hulumtimi nxënësit nuk do të lënë pas dore, lidhjen e ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe në kontekstin politik, historik, artistik, etj.

Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit
- Rezultatet e të nxënësit
- Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës. Kjo tabelë lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili anëtar i grupit. Një shembull tabele e planit të veprimtarive paraqitet më poshtë:

Faza e parë		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtar i grupit
P.sh. Hulumtimi i ngjarjeve kulturore, politike dhe historike, artistike dhe muzikore	15 tetor 201..	Anëtar i
P.sh. Hulumtimi i ngjarjeve artistike dhe muzikore	20 tetor 201...	Anëtar i

Interpretimi i të dhënave të gjetura	25 tetor 201...	Anëtari
.....		
Faza e dytë		
P.sh. Grumbullimi i materialit nga burime të tjera	10 Janar 201..	Anëtari
.....		
P.sh. Seleksionimi i të dhënave dhe përpunimi i materialeve	2 shkurt 201...	Anëtari
.....		
Faza e tretë		
P.sh. Shkrimi i materialit	9 Mars 201..	Anëtari
.....		
P.sh. Punimi i materialit në kompjuter	3 Prill 201...	Anëtari
.....		
P.sh. Përgatitja e projektit për prezantim	15 Prill 201..	Anëtari ...
.....		

- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrim i shkurtër i projektit.
- Gjetjet e projektit. *(Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik power point, nëse është produkt, prezantohet produkti etj.)*
- Konkluzione të projektit.

8.4 Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas tabelës 3 për vlerësimin e projekteve kurrikulare të përcaktuar sipas niveleve të mësipërme. Gjatë vlerësimit merret në konsideratë:

- Vetorientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Gjetja e zgjidhjeve në situata të ndryshme dhe arsyetimet intuitive.
- Përdorimi i saktë i koncepteve muzikore.

- Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme muzikore.
- Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit, individualisht dhe në grup.
- Mënyra e prezantimit të projektit, i cili të lexohet, të dëgjohet dhe të kuptohet qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

8.5 Vlerësimi i të nxënësve të nxënësve

- Vlerësimi periodik,
- Vlerësimi përfundimtar.

8.5.1 Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik është dokumentimi në regjistrë të rezultateve të vlerësimit të nxënësve për secilën periudhë. Ai përmban 2 (dy) nota:

- Notën e vlerësimit të vazhduar,
- Notën e vlerësimit me detyrë përmbledhëse.

Këto dy vlerësime me notë shënohen në regjistrë në kolonat përkatëse.

8.5.2 Vlerësimi përfundimtar

- Vlerësimi përfundimtar realizohet me notë, në përfundim të vitit shkollor.
- Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:

Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha.

Notën vjetore të vlerësimit me detyrë përmbledhëse për tri periudha.

Nota e vlerësimit të projektit.

Peshat në përqindje sipas vlerësimeve janë:

	<i>Pesha në përqindje klasat VI-XII</i>
<i>Vlerësimi i vazhduar</i>	40%
<i>Vlerësimi me detyrë përmbledhëse</i>	40%
<i>Vlerësimi i projektit kurrikular</i>	20%

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:

- Nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.

- b) Nota vjetore e vlerësimit me detyrë përmblledhëse (NTp/Dp) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit me detyrë përmblledhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- c) Nota e vlerësimit të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në procesin e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar.
- d) Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse. Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 9).
- e) Formulatat për llogaritjen e notës përfundimtare janë:
- $\text{Nota përfundimtare në klasat X-XII} = (NV_v \times 0.4) + (NTp/Dp \times 0.4) + (NV_p \times 0.2)$
- f) Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënësve sipas periudhave është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë <i>Shtator – Dhjetor</i>		Periudha e dytë <i>Janar - Mars</i>		Periudha e tretë <i>Prill - Qershor</i>		Vlerësimi vjetor			Nota përfundimtare
NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _p	
6	6	8	7	8	7	8	7	9	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.8$$

Nota përfundimtare 8

OSE

$$(7 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.4$$

Nota përfundimtare 7

8.6. Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të bëhet në mënyrë të tillë që t'u japë atyre mundësinë të demonstrojnë çfarë dinë dhe mund të bëjnë në përmbyllje të rezultateve të të nxënësve.

Për këtë qëllim mësuesi duhet të përshtatë detyrat/veprimtaritë vlerësuese me mundësitë dhe nevojat që këta nxënës kanë. Këto modifikime mund të përfshijnë:

- Ndryshimin/përshtatjen e formateve alternative të pyetje/përgjigjeve, p.sh. një formë të përgjigjes më të thjeshtuar (bazuar në disa pika orientuese) në vend të një eseje që duhet të përgatisin nxënësit.
- Modifikime të veprimtarive vlerësuese, p.sh. duke thjeshtuar gjuhën e përdorur, ose duke përdorur një format tjetër të pyeturi.
- Përshtatje të procesit të vlerësimit, p.sh. duke i dhënë kohë shtesë nxënësit, me pauza të ndërmjetme, duke përdorur një lexues ose teknologji specifike.

Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

IX. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRA TË NDRYSHME NË LËNDËN E MUZIKËS, AML

9.1. Kriteret për kryerjen e detyrave

Mësuesi duhet të përcaktojë kriteret vlerësimi për çdo detyrë dhe të sigurojë udhëzime të qarta për nxënësit se si do të jetë detyra e përfunduar dhe si do të zbatohen kriteret. Kur vendosni një detyrë sigurohuni që:

- kërkesat e detyrës janë bërë sa më qartë të jetë e mundur për nxënësin;
- kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes t'i ofrohen çdo nxënësi në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë;
- çdo burim ose material i përdorur të jetë i qartë dhe i përshtatshëm për detyrën;
- arritjet e nxënësit maten për më shumë se një rezultat të nxëni;
- udhëzimet të jenë të qarta dhe koncize;
- niveli i gjuhës të jetë i përshtatshëm për vlerësimin;
- detyra nuk përmban gjini, kulturë ose ndonjë paragjykim tjetër;
- koha e lejuar është e mjaftueshme për kryerjen e detyrës.

9.2. Reflektimi i mësuesit

Kur vlerësoni detyrën, mos harroni se reflektimet tuaja do të ndihmojnë nxënësin të kuptojë pse ai / ajo mori atë rezultat dhe si mund të bëhet më mirë herën tjetër.

Reflektimi duhet të jetë:

- konstruktiv në mënyrë që nxënësi të ndihet i inkurajuar dhe i motivuar për t'u përmirësuar;
- në kohë, në mënyrë që nxënësi ta përdorë atë për të mësuar në vazhdim;
- i menjëhershëm në mënyrë që nxënësi të mund të mbajë mend atë që bëri dhe të reflektojë në kohë;
- i fokusuar në arritje dhe përpjekje, jo te personi - puna duhet të vlerësohet, jo nxënësi;
- specifike për rezultatet e të nxënit në mënyrë që vlerësimi të jetë i qartë lidhur me të mësuarin.

Përgjigjet tuaja mund të jenë:

- informale ose indirekte - të tilla si reagimet verbale në klasë (me tërë klasën), ose në mënyrë individuale me vetë nxënësin.
- formale ose të drejtpërdrejta - të tilla si listat e kontrollit ose komentet për nxënësin në mënyrë individuale në formë të shkruar ose verbale;
- formative – të dhëna gjatë mësimit me qëllim ndihmës për nxënësin që të di se si të përmirësohet;
- përmbledhëse – të dhëna në fund të periudhës (ose të kapitullit) me qëllim informimin e nxënësve për çfarë kanë arritur.